Të burgosurit politik 1946/1999 në komunën e Hanit të Elezit nga autori Shaban Çupi



Islam Brava (1893- 1976)

Islam Muharrem Brava u lind në vitin 1893 në fshatin Puset e Nikës të Hanit të Elezit. Pas kapitullimit të pushtuesit bullgar dhe vendosja e pushtetit gjerman në Han të Elezit, Islam Brava emërohet kryetar komune në Han të Elezit. Meqë forcat partizano çetnike, në vitin 1944, bënin përpjekje të depërtojnë nga ana jugore, pra nga Shkupi në drejtim të Kosovës, kryengritësi Avdyl Dura me bashkëluftëtarë, arriti të organizoj një rezistencë të fuqishme në Karadak të Shkupit. Islam Brava, si kryetar komune, me tërë ndikimin e tij, bëri që kjo rezistencë të fuqizohet dhe e

mbështeti me të gjitha forcat dhe njëherit ishte edhe në Shtabin e rezistencës. Jo vetëm kaq, në këtë luftë iu vra edhe djali i tij shtatëmbëdhjetë vjeçar Ademi. Humbja e luftës së frontit të rezistencës, bëri që forcat partizano çetnike të bëjnë një llahtari në fshatrat e kësaj ane, ku më së rëndi e pësoi fshati Bllacë i Shkupit, ku u pushkatuan 111 kryefamiljarë. Vendosja e pushtetit të Jugosllavisë së Avnojit në vitin 1945, bëri që të kërkohen armiqtë e këtij pushteti, kështuqë në janarin e vitit 1946, nën pranga të OZN-a u gjend Islam Brava. E burgosën në shtëpinë e uzurpuar të Perës në Gjilan dhe pas disa muaj hetime të rënda Islam Bravën e nxorën para gjyqit.
Kur u dënua Islami, kujtonte kusheriri i tij Zelfi Brava, tanimë i ndjerë, në gjyq shkova bashkë me Hasip Bravën. Në gjyq e sollën me pranga në këmbë e duar dhe meqë Islami ishte një burrë i gjatë, por edhe më të gjatë e bënin tirqit dhe xhurdia, të dukej një burrë vigan dhe disi i ngjante Isa Boletinit.
E dënuan me 101 vite burg të rëndë. Akuza e ngarkonte se si kryetar komune ka ndihmuar frontin e rezistencës të Avdyl Durës si dhe gjatë pushtetit të tij te Dheu i Bardhë që gjendet në afërsi të Hanit të Elezit, ishin vrarë disa serb të Shtërpcës.
Pas dënimit, Islam Bravën e transferojnë në burgun e Mitrovicës së Sremit. Gjatë vuajtjes së dënimit, bëri një

marrëveshje me gruan e tij që të shkurorëzohen për shkak të reprezaljeve të pushtuesit ndaj familjes. Gruaja e Islamit bashkë me djalin Nejaziun shkojnë në Turqi, ndërsa Islami mbetet në burgun e Mitrovicës së Sremit. Ndërkohë, dënimi i shqiptuar i zbritet në 20 vite prej të cilëve mbajti 16 vite burg.

Islam Brava ka pasur shumë miq, kujtonte Zelfi Brava. Shokët e tij ishin nga Pollogu e Dërveni, Shkupi e Shkodra. Njihej mirë me Muharrem Fejzën nga Hogoshti, Ramë Bllacën, Lam Breznicën, Hysen Tërpezën, Xhemail Ferën nga Bllaca e Shkupit, Kadri Rakën dhe Ismail Hoxhën e Kaçanikut.

Pas vuajtjes së dënimit, kthehet në fshatin e lindjes në Puset e Nikës. Pastaj shkon në Turqi te gruaja dhe djali Nejaziu, por kthehet sërish në Shkup dhe vdes te vajza e tij në vitin 1976 dhe varroset në varrezat e qytetit të Shkupit.

Jeta dhe vepra e Islam Bravës është përfshirë në librin „Jatakët e lirisë" të autorit Shaban Çupi, duke shfrytëzuar edhe burime arkivore, si dhe në revistën „E vërteta'' e cila botohej në Shkup, para lufte, nga i njejti autor.

Ali Huneli (1905 – 1982)

Krahas arrestimit të Islam Bravës, në një proces tjetër, në gushtin e vitit 1946, arrestohet edhe Ali Huneli nga fshati Rezhancë.

Ali Huneli ishte i lindur në vitin 1905. Pas LDB ishte kryetar komune në Han të Elezit dhe ka pasur kontakte me Fahri Shurdhanin nga Kaçaniku për zgjerimin e radhëve të NDSH(Organizata Nacional Demokratike Shqiptare). Pas gjashtë muaj hetime në burgun e Gjilanit, Ali Huneli lirohet nga ndjekja e mëtejme, pasiqë edhe Fahri Shurdhani në ballafaqim me Aliun, dëshmon se ka pasur kontakte me Aliun, ka biseduar për situatën politike, por nuk e ka angazhuar në NDSH. Natyrisht, kjo ishte një deklaratë lehtësuese për Aliun, andaj më 10 shkurt 1947, lirohet nga aktakuza. Në vendimet gjyqësore thuhet se, Ali Huneli lirohet

nga aktakuza me arsyetim se veprimtaria e tyre gjatë seancës së mbajtur me datën 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 shkurt 1947 nuk ka arritur të vërtetohet. Kurse ndaj 32 anëtarëve të tjerë të NDSH u shqiptohen dënime të rënda.

Ali Huneli vdes në vitin 1982 në moshën 77 vjeçare dhe varroset në varrezat e fshatit në Rezhancë.

Veprimtaria e Ali Hunelit është përfshirë në librin „Jatakët e lirisë" të autorit Shaban Çupi.

Nazmi Brava (1896 – 1969)

Nazmi Brava u lind në vitin 1896 në fshatin Puset e Nikës të komunës së Hanit të Elezit.Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për një kohë veproi edhe në njësitë bullgare kontraçetnike, synimi i të cilave (edhe pse nën ombrellën e pushtuesit bullgar) ishte luftimi i çetnikëve. Derisa ishte në shërbim të kontraçetnikëve, arrijnë që bashkë me Islam Bravën ta shpëtojnë antifashistin me emrin Tefik nga Shkodra të cilin gjermanët e kishin zënë robë lufte.

Pas LDB-së, Islam Brava shkoi në Shkodër për të vizituar Tefikun ku edhe pritet me ngrohtësi nga Tefiku dhe familja e tij. Lidhjet me Tefikun nga Shkodra janë mbajtur edhe në vitet e 90-ta të shekullit XX, ku familjes Brava u dërgoi si peshqesh katër plisa të bardhë, plisa Shipnie.

Fundi i vitit 1944 dhe 1945, Nazmi Bravën e gjen në Brigadat e Nacional Çlirimtares në ndjekje të fashizmit

dhe në këto ndjekje, Nazmiu e vërtetoi se jeta e shqiptarit nën pushtetin komunist do të jetë edhe më e rëndë. Vrasja e shqiptarëve pas shpine nëpër frontet e luftës si në Tivar, Srem, Trogir e kudo tjetër, bënë që Nazmiu ta ndante mendjen se Jugosllavia e re e Avnojit s`është asgjë tjetër pos një varri i ri për shqiptarët, andaj që në fillet e saj e luftoi.
Burgosja e Islam Bravës ishte një përjetim i rëndë për atdhetarin Nazmi Brava pasi që Islamin jo vetëm që e kishte të afërt e të gjakut, por me Islamin, Nazmiun e lidhte një veprimtari e gjerë e përbashkët atdhetare, sidomos lufta që u zhvillua në Karadak të Shkupit në vjeshtën e vitit 1944.
Burgosja e Islamit, masakrat dhe tmerret që bënte pushtuesi sllavokomunist në çdo shtëpi shqiptare dhe plot ngjarje të tjera si këto bënë që nga kjo kohë Nazmi Brava të kërkoj shkëndija lufte kundër pushtuesit jugosllav dhe kjo shkëndijë që synonte të bëhej një ditë një flakë e madhe, ishte dalja në mal e tribunit të Grykës së Kaçanikut, atdhetarit Avdyl Duraj me shumë shokë të tij si Ramë Beka e Sadik Tusha që me armë në dorë kishin vendosur luftimin e këtij pushtuesi famëkeq i cili për 50 vite me radhë do t`ua pinë gjakun shqiptarëve herë haptazi dhe shumë herë fshehurazi.
Në rrjedhë të kërkimit të këtyre armiqve kërkohej edhe

Avdyl Dura me shokë, të cilët që në muajt e parë të „çlirimit" ishin arrestuar nga organet e pushtuesit jugosllav, por që një natë kishin arritur të ikin nga burgu dhe me një betim të prerë se të gjallë kurrë s`do të bien në duart e këtyre gjakpirësve, u ngjitën thepave, shpellave dhe grykave të Sharrit epik.
Bukëdhënës i këtyre kryengritësve ishte Nazmi Brava dhe jo vetëm kaq Nazmiu ishte edhe një informator i këtyre forcave kryengritës dhe përcjellte lëvizjet e OZN-as.
Arrestohet më 3 janari i vitit 1948 dhe hetimet zhvillohen në burgun e Gjilanit. Për një vit me radhë prangat do t`i mban në këmbë. Hetues i tij ishte gjakpirësi Aleksa Vuqiniqi i quajtur „ Vuqa" i cili i shkallmonte shqiptarët në këto zyre hetuese, ndërsa sllavokomunisti Ali Shukriu ishte prokurori i gjykatës armike i cili shprehte mllefin „juridik" mbi bashkëkombasit e tij, ndërsa gjykatësi rus Zaharije Orgjonikidze ua „prente'' teshat e robërisë shqiptarëve me pushkatim ose burg me dekada. Kryetari i trupit gjykues ishte Sime Mileniqi. Fillimisht e dënojnë me pushkatim, por me kalimin e kohës, dënimi do t`i zbritet. Duke u mbështetur në dokumentet arkivore, dhe nga një kërkesë për falje e vitit 1950 e shkruar në emër të gruas së tij Sadikes, figurojnë edhe emra të tjerë, madje edhe i komandantit dhe i komisarit të

Brigadës nga fronti i Sremit. Në këtë listë emrash për zbutjen e dënimit ndaj Nazmi Bravës, figurojnë edhe emrat e autoriteteve lokale si i Ramiz Bushit dhe Bajram Laçit nga Puset e Nikës dhe i kryetarit të Këshillit Popullor në Han të Elezit, Halil Bushit. Pas kësaj lutje, Nazmi Bravës dënimi do t`i zbutet në 10 vite, duke i mbajtur vetëm 6 sosh.

Pas daljes nga burgu, Nazmi Brava e kishte obligative lajmërimin për çdo javë në stacionin policor të Kaçanikut dhe kohë pas kohe edhe izolohej.

Nazmi Brava ishte një arsimdashës i madh. Mësuesit ishin nga vende të ndryshme, madje edhe nga Shala e Bajgorës dhe ishte gjithnjë në ndihmë të tyre edhe me strehim. Vdes në vitin 1969 në Puset e Nikës i dashur dhe i nderuar nga të gjithë.

Jeta dhe vepra e Nazmi Bravës është përfshirë edhe në librin „Jatakët e lirisë" të autorit Shaban Çupi. Shtëpia e tij dhe e farefisit, gjatë luftës ishin kazerma të luftës sonë të lavdishme, ndërsa i tërë farefisi i tij nga gjaku, ishin pjesëtarë të UÇK-së.

Rufat Brava (1906-1988)

Rufat Brava është i lindur në fshatin Puset e Nikës në vitin 1906. Ka punuar në minierën e fshatit Radushë dhe në xeheroren e asbestit në Puse të Nikës. Pas Luftës së Dytë Botërore është zgjedhur këshilltar pranë Këshillit Vendor në Han të Elezit. Arrestohet më 3 janar 1948, bashkë me Nazmi Bravën e Halil Rogaqin. Edhe Rufatin, aktakuza e ngarkonte si bashkëpunëtor të Avdyl Durës. Burgoset në burgun e Gjilanit, ku ashtu si shokët e tjerë torturohet rëndë. Akuzohej se ka ndihmuar Avdyl Durën me bukë, strehim e informacion. Hetimet ndaj tij i zhvillonte Aleksa Vuqiniqi. Në një procesverbal të OZN-ës gjatë marrjes në pyetje, thuhet;

Nuk më kujtohet data e saktë, por mendoj se ka qenë muaji korrik i vitit 1947 kur në gjysmë të natës dikush ka trokitur në dyert e mia. Kur kam pyetur se kush

është? Ai është përgjigjur se jam një njeri që shes duhan dhe më ka zënë nata. Unë hapa derën dhe vërejta një grup njerëzish e në mesin e tyre e njoha Avdyl Durën. Avdyli më kërkoi bukë... Me vazhdimin e hetimeve, vërtetohet se Rufati ka pasur edhe shumë kontakte të tjera me Avdyl Durën e bashkëluftarët e tij.
Rufat Brava u dënua me 5 vite burg të cilin e vuan në burgun e Mitrovicës së Sremit ku arriti të njeh edhe shumë shokë të tjerë. Rufat Brava vdiq në Shkup në vitin 1988. Veprimtaria e Rufat Bravës është përfshirë në librin „Jatakët e lirisë'' të autorit Shaban Çupi.

Halil Rogaqi (1895 – 1969)

Halil Rogaqi u lind në vitin 1895 në fshatin Rezhancë të komunës së Hanit të Elezit. Arrestohet më 3 janar 1948 si bukdhënës dhe strehues i kryengritësit Avdyl

Dura. Torturat ndaj tij, fillojnë që në Han të Elezit dhe te Ura e Fejzë Bushit e fusin në ujë të ftohët në lumin Lepenc, dhe krahas torturës me ujë të ftohtë, ia thyejnë edhe krahun. Torturat tjera vazhdojnë në Ferizaj, për të përfunduar me plot tmerr në burgun e Gjilanit, ku krahas torturave tjera edhe e kastrojnë. Përkundër këtyre torturave, OZN-a nuk arrin ta thyej Halilin, por ndërkohë, inskenohet një kurth i OZN-as dhe i bëjnë bashkë në një dhomë Nazmi Bravën, Halil Rogaqin dhe Rufat Bravën, pa e ditur këta se janë nën inçizim të OZN-as, përkatësisht UDB-së. Halili u thotë shokëve të tij se meqenëse jeta ime ka përfunduar, më ngarkoni ju me veprat tuaja dhe unë në gjyq i pranoj të gjitha, por kur dolën në gjyq, ju tregohet inçizimi i bërë fshehurazi.

Në aktakuzë, ndër të tjera thuhej se Halil Rogaqi nga fshati Rezhancë, ka mbajtur takime të rregullta me grupin e të arratisurit Avdyl Dura, ka mbajtur mbledhje me ato, i ka njoftuar për ndjekjet që ka bërë pushteti popullor ndaj tyre dhe i ka strehuar. Gjatë vitit 1946 dhe 1947 ka mbajtur lidhje të vazhdueshme dhe ka qenë njeriu më i besuari i tyre dhe i ka njoftuar për lëvizjet e pushtetit popullor, ju ka ndihmuar në luftë kundër rregullimit kushtetues të Jugosllavisë me çka ka kryer vepër penale nga neni 3 pika 7 dhe 14 e kodit penal.

Halil Rogaqi u dënua me 5 vite burg të cilët i vuan në Mitrovicën e Sremit ku arriti të njeh shumë veprimtarë të çeshtjes kombëtare të anëve të ndryshme. Aty njohu edhe shumë endesheistë NDSH dhe hoxhallarë të cilit kishin qenë bashkëpunëtorë të Mulla Haki Sermagjajt e Idris Gjilanit. Nga këto shokë burgu, mësoi edhe mjeksinë popullore të cilën e përdori deri në fund të jetës së tij. Gjerisa ishte në vuajtje të dënimit, gjatë shërbimit ushtarak jugosllav, ia burgosin edhe djalin e tij Kadriun i cili tentoi që të arratisej në Austri. Halil Rogaqi vdiq në vendlindjen e tij në vitin 1969. Veprimtaria e Halil Rogaqit është përfshirë në librin „Jatakët e lirisë" dhe në librin „Gjurmime etnologjike në trevën e Hanit të Elezit" nga autori Shaban Çupi.

Shefket Thaçi (1917 – 1978)

Shefket Thaçi u lind në vitin 1917 në Kryenik të Hanit të Elezit. Në vitin 1937 ka qëndruar në burgun e Shkupit si i dyshuar për një vrasje të një serbi. Pas kapitullimit të Jugosllavisë së krajlit, shkon në Shqipëri, sepse në trevën e Hanit të Elezit vendoset pushtuesi bullgar. Ka ditur shkrim lexim shqip dhe nga një letër e tij kuptohet se ai në Shqipëri ka qëndruar nga 17.5.1941 e deri më 5.11.1943 dhe merr pjesë në luftën antifashiste atje.

Në vitin 1944, vie në fshatin e tij të lindjes dhe lajmërohet si vullnetar në LNÇ dhe ishte i sistemuar në Brigadën e Parë sulmuese të Brigadës XII të Divizionit IV të ushtrisë jugosllave në Knin të Dalmacisë. Në ushtri qëndron 18 muaj dhe ishte komandant i një çete dhe demobilizohet si i moshuar. Rëndë e përjeton mbytjen në ujë në Trogir të 29 ushtarëve shqiptarë të

mobilizuar në ndjekje të fashizmit nga rrethina e Kaçanikut dhe e Hanit të Elezit. Pas demobilizimit zgjedhet në pushtetin popullor si këshilltar në Këshillin e Vendit të Hanit të Elezit.

Pas arrestimit të Nazmi Bravës, Rufat Bravës e Halil Rogaqit, më 14 janar 1948, arrestohet edhe Shefket Thaçi. Aktakuza e ngarkonte se si anëtar i Këshillit Popullor të Vendit në Han të Elezit, për një kohë të gjatë ka mbajtur lidhje të ngushta me grupin e të arratisurve në krye me Avdyl Durën, i ka ndihmuar materialisht, i ka ndihmuar dhe ka marrë pjesë në mbledhjet e tyre, ka ditur për qëndrimi dhe lëvizjet e tyre dhe si anëtar i Këshillit Popullor ka qenë i obliguar t`i ndjek dhe t`i zbuloj, ndërsa ai përkundrazi, i ka ndihmuar dhe ju ka shërbyer si strehues (jatak). Ai në datën e pavërtetuar të muajit shkurt 1947 e ka pranuar të arratisurin Avdyl Dura dhe me atë ka mbajtur mbledhje dhe nga mulliri i tij i ka dhënë 100 kg. miell si dhe nuk ka lajmëruar askënd nga organet e pushtetit, ka mbajtur kontakte me Avdyl Durën dhe nga mulliri i tij e ka furnizuar me miell, informacion e strehim. Kjo dëshmohet edhe në procesverbalin e OZN-ës ku thuhet se ,,Avdyl Durën nuk e kam njohur gjatë ish Jugosllavisë, as gjatë kohës së okupimit. Me atë njihem që nga koha që ka kaluar në arrati dhe atë nga shkurti i vitit 1947, disa ditë pas luftës që ka

zhvilluar Avdyl Dura me grupin e tij në fshatin Shtrazë ku edhe u plagos nëntogeri i UDB-së Ilija Hovjecki. Ai më tregoi se ka zhvilluar një luftë në fshatin Shtrazë dhe tani kemi ardhur në terrenin tuaj dhe më kërkoi që të siguroj ushqim për grupin...

Gjykata e Qarkut në Gjilan, Shefket Thaçin e dënoi me tre vite burg të cilin edhe e vuan. Vdes në Shkup në vitin 1978. Jeta dhe veprimtaria e tij është përfshirë në librin „Jatakët e lirisë " të autorit Shaban Çupi e cila është botuar në vitin 2014.

Kadri Halil Rogaqi (1928-1993)

Është i lindur në vitin 1928 në fshatin Rezhancë të Hanit të Elezit. Pas burgosjes së babait të tij Halilit në vitin 1948, Kadri Rogaqit i vie ftesa për shërbim ushtarak në Kranj të Sllovenisë. Si bir „ballisti" që ishte, ndjekjet ndaj tij në armatën jugosllave ishin të padurueshme, andaj bashkë me një shok të tij nga Prizreni, dezertojnë nga armata Jugosllave dhe nisen në drejtim të Austrisë. Meqë ishte borë e madhe dhe rreziqet nga ortekët në Alpe ishin të pashmangshëm, detyrohen të kthehen sërish nga kufiri austriak, në atë jugosllav, për të gjetur

ndonjë dalje më të përshtatshme. Acari i madh i detyron që të kërkojnë ndihmë te një shtëpi sllovene. Pronarja e shtëpisë i pret mirë, por në anën tjetër i lajmëron organet ushtarake dhe që të dy i arrestojnë. Për disa me radhë i mbajnë të mbyllur në një shpellë, pastaj ua dorëzojnë organeve të hetuesisë. Për dezertim nga armata jugosllave dhe për tentim të kalimit ilegal të kufirit, Kadri Rogaqi nga gjykata ushtarake dënohet me pesë vite burg. Kadri Rogaqi ishte një burrë punëtor, i qetë dhe mikëpritës. Vdiq në Han të Elezit në vitin 1993.

Gafurr Loku (1949-1999)

Gafurr Loku u lind më 11 gusht 1949 në fshatin Kotlinë të Kaçanikut. Një pjesë të shkollës fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa pjesën tjetër në Han të Elezit. Në vitin 1960 shpërngulet në Tetovë, ku edhe

regjistrohet në gjimnazin e Tetovës. Me 4 maj 1968, si nxënës i vitit të dytë, bashkë me shokun e tij Rafi Halilin e ngritën flamurin kombëtar shqiptar në fabrikën e Tekstilit në Tetovë. Merr pjesë fuqishëm në demonstratën e 22 dhe 23 dhjetorit 1968 në Tetovë. Në vitin 1970 regjistrohet në Fakultetin Ekonomik të Prishtinës. Gjatë vitit 1969, 1970, 1971 formon celula atdhetare për çlirimin e trojeve shqiptare si në Tetovë, Gjepçisht, Poroj, Zhelinë, Shipkovicë, Gajre, por detyrë kishte që celula të tilla të ngriste edhe në fshatrat e Grykës së Kaçanikut e më gjërë. Gjatë këtyre viteve Gafurr Loku dhe bashkëveprimtarët e tij, arrijnë të ngritin flamujtë kombëtarë shqiptarë në të gjitha qytetet shqiptare në Maqedoni. Më 28 nëntor 1970 miratohet Statuti i Organizatës Politike Kombëtare „Kushtrimi i lirisë" dhe Gafurr Loku në kuadër të kësaj Organizatës ilegale zgjedhet Kryetar i Këshillit kombëtarë të organizatës. Gafurr Loku merr pjesë në marrjen e pushkëve nga kabineti paraushtarak i gjimnazit, armë të cilat i dedikoheshin Organizatës për rezistencë të armatosur. Me 1 maj dhe 4 korrik 1972 Gafurr Loku me shokë, vendosin flamurin kombëtarë shqiptarë në sheshin e qytetit të Tetovës dhe në qytete të tjera. Me 26 korrik 1972 është shpërndarës i pamfleteve në afërsi të Universitetit të Tetovës dhe Bibliotekës së qytetit. Me 21 shtator 1972 arrestohet në

Prishtinë. Hetimet ndaj Gafurr Lokut zhvillohen në burgun famëkeq të Shutkës së Shkupit. Me 21 janar 1973 del para gjyqit të Shkupit dhe dënohet me 5 vite burg. Pas përfundimit të hetimeve transferohet në burgun famëkeq të Idrizovës. Në këtë burg takohet me dëshmorin Rexhep Mala. Në burgun e Idrizovës qëndron me: Rafi Halilin, Rushit Nesimin, Elmaz Ademin, Ajet Ademin, Shpëtim Pollozhanin dhe me të burgosurit politik nga Kosova: Ajet Runikun, Xhafer Shatrin, Hasan Dërmakun, Nejazi Korçën, Binak Ulajn, etj. Në vitin 1976 familja e tij shpërngulen nga Tetova dhe vendosen në fshatin Seqishtë të Hanit të Elezit. Pas daljes nga burgu, në maj të vitit 1978, qëndron i shtrirë në spitalin e Prishtinës si pasojë e dëmtimit të mushkrive në burg. Në vitin 1978 martohet me Hasibe Rakën nga Kaçaniku. Në vitin 1979 i lind djali i tij Dritoni, të cilin serbët ia vrasin pas njëzet viteve. Në vitin 1979, rivendosen kontaktet me Rexhep Malën i cili ende mbahej në burg. Përsëri vazhdon studimet pranë Fakultetit Ekonomik në Prishtinë, të cilin ia kishin ndërprerë dhunshëm në vitin 1972. Në vitin 1979 përsëri shpërngulet në Tetovë. Në prill të vitit 1980 dërgohet në kryerjen e shërbimit ushtarak në Sarajevë ku qëndron vetëm 3 muaj. Pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 ishte njëri prej propaganduesve më të fuqishëm të kërkesës politike:

Kosova-Republikë. Është në njohuri të aksionit të shpërndarjes së pamfleteve në Tetovë e rrethinë të datave: 27 qershor 1981, 8 korrik 1981, 16 shtator 1981, 17 shtator 1981, 21 dhjetor 1981 të cilat i shpërndante organizata ilegale „Kushtrimi i Lirisë" në krye me atdhetarin Rafi Halilin i cili vdiq më 28 janar 2022. Me 9 mars 1982 i bastiset shtëpia e tij në Tetovë, ku arrestohet edhe vëllau i Gafurrit, Kadri Loku dhe për tre muaj ditë torturohet rëndë. Më 13 mars 1982, UDBja e arreston edhe Gafurr Lokun në Kaçanik. Hetimet ndaj Gafurrit zhvillohen përsëri në burgun e Shutkës. Gafurr Loku me 16 gusht 1982 del para Gjykatës së Qarkut në Shkup dhe dënohet me 3 vite e 6 muaj burg, të cilin dënim e vuan përsëri në burgun e Idrizovës. Duke llogaritur edhe burgun e parë, mbajti gjithësejt 8 vite e 6 muaj burg. Pas dënimit të dytë të Gafurrit, përsëri familja e tij nga Tetova shpërngulen në Kosovë, konkretisht në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Nga burgu i dytë lirohet me datën 14 shtator 1985 dhe të njejtën ditë i vdes babai i tij Xhaferi. Përsëri vazhdon studimet në Prishtinë dhe arrinë t`i përfundoj tri vite të Fakultetit Ekonomik. Në vitin 1987 doli në Zvicërr, por qëndron vetëm 2 muaj ditë. Në Zvicërr kontakton me bashkëveprimtarë nga Kosova e Tetova dhe pas dy muaje, përsëri kthehet në Kosovë. Gjatë këtij viti, kishte përpjekje për ta arrestuar për herë të tretë. Gjatë

viteve 1990-1991, në bashkëveprim me grupin e ish të burgosurve politik në Han të Elezit, ishte aktiv në grumbullimin e mjeteve materiale për blerjen e armëve dhe krijimin e njësiteve guerile. Viteve të 90-ta, kur u themelua Këshilli i Financimit në Han të Elezit (1992), Gafurr Loku ishte sekretar i këtij këshilli. Që të mbijetoj shkolla shqipe, Gafurr Loku ishte edhe inkasant i këtij Këshilli. Mori pjesë në të gjitha demonstratat dhe protestat që u zhvilluan në Han të Elezit. Merr pjesë në pajtimin e zënkave dhe gjaqeve në Han të Elezit dhe më gjërë. Me themelimin e Shoqatës Humanitare ,,Nëna Terezë'' (1994) në Han të Elezit ishte kryetar i saj. Ishte edhe anëtar i kryesisë edhe në Nënkëshillin për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut (1997) në Han të Elezit. Në prill të vitit 1998, për pjesëmarrje në demonstrata në Han të Elezit kundër pushtuesit serb, torturohet rëndë i biri i tij Driton Loku. Në vitin 1998, Gafurr Loku, kontakton edhe me Agim Bajramin komandantin dhe themeluesin e Brigadës së UÇK-së në Kaçanik. Me formimin e Shtabit Lokal të UÇK-së me 19 qershor 1998 në Puset e Nikës, ishte në lidhje direkte me Shtabin dhe nga ai ngarkohet me detyra konkrete për masovizimin e UÇK-së me ushtarë të rinjë, në furnizimin e njësitit me armatim, mjete materiale dhe ndihma të tjera për nevojat ushtarake. Gafurr Loku bashkë me djalin e tij Dritonin, vriten me 21 shkurt

1999 në Paldenicë të Hanit të Elezit nga pushtuesi serb. Varrimi i tij bëhet me 24 shkurt 1999 në fshatin Paldenicë. Gjatë luftës, Brigada 164 e UÇK-së në Han të Elezit, mori emrin e tij. Zhvarrimi i tij bëhet me 21 shkurt 2001 dhe rivarroset në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës. Kazerma e TMK-së në Han të Elezit kishte emrin e tij. Për dëshmorin janë thurur këngë, janë shtypur libra dhe është realizuar një Dokumentar. Me vendim të Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në gushtin e vitit 2019, Gafurr Loku është shpallur Hero i Kosovës.

Abit Kuka është i lindur në fshatin Seçishtë të Hanit të Elezit, më 27 shtator të vitit 1964. Pas shkollës fillore që e kreu në Han të Elezit, të mesmen e kreu në Kaçanik. Jehona e demonstratave të vitit 1981, ishte përhapur gjithandej, andaj kjo dritë lirie preku edhe shpirtin liridashës të Abit Kukës.

Ishin kohëra kur burgosjet ishin masive, por edhe rezistenca për liri ishte aktive. Ate s`mundën ta shuanin as arrestimet, as dënimet e as torturat. Brenda parullës politike Kosova–Republikë, ishte dhe qëndronte liria dhe çlirimi i popullit shqiptarë, andaj pushtuesi jugosllav e luftonte me të gjitha forcat. Synonin që me çdo kusht ta mbysnin këtë ide politike. Mjaftonin nistoret e kësaj parulle si K.R. dhe të përmbysej jeta. Megjithate, djalëria shqiptare kishte thyer prangat e frikës dhe kishte vendosur që deri në fund të luftoj për kauzën e saj. Kështuqë, në muajin korrik të vitit 1983, Abit Kuka, aty në asfaltin e rrugës ndërmjet fabrikës së çimentos „Sharr" dhe „Sallonit" tek rruga që lidhej edhe me Shkupin, në një gjatësi prej 8 metrave shkroi parullën Kosova Republikë, Bashkim dhe Rroftë populli shqiptarë! Këto parulla u shkruan gjatë natës. I tërë mekanizmi politiko – shtetëror jugosllav ngriten për të zbuluar autorin e parullës. Kjo vepër e Abit Kukës zbulohet pas pesë dite, zbulohet me 28 korrik 1983, dhe arrestohet Abit Kuka. Torturohet në stacionin policor të Kaçanikut, natyrisht për të zbuluar edhe anëtarë të tjerë nacionalist e irredentistë siç u thonin atëherë.

Dënohet me 60 ditë burg, të cilin e vuan në Prishtinë dhe në Gurrakoc. Edhe pas kryerjes së dënimit Abit Kuka për një vit me radhë çdo javë ka qenë i detyruar

të lajmërohet në stacionin policor të Kaçanikut ku merrej në pyetje nga udbashët Halit Loku e Afet Rexhallari, duke kërkuar informata të tjera rreth veprimtarisë së tij dhe natyrisht duke i bërë presione e shantazhe nga më të ndryshmet. Është i martuar dhe babai i tre fëmijëve.

Bajram Dernjani është i lindur më 11 korrik 1961 në fshatin Paldenicë të komunës së Hanit të Elezit. Pesë klasët e shkollimit fillor i kreu në fshatin e lindjes, ndërsa pjesën tjetër në Han të Elezit. Shkollën e mesme e kreu në gjimnazin e Kaçanikut. Në tetorin e vitit 1980 shkon për të kryer shërbimin e detyruar ushtarak jugosllav në Podgori-

cë. Pas kryerjes së shërbimit ushtarak, në tetorin e vitit 1981 fillon studimet pranë Fakultetit Juridik në Prishtinë dhe ishte një student shumë i dalluar. Që nga shpërthimi i demonstratave të vitit 1981, Bajram Dernjani, bëhet pjesa shpirtërore e kësaj epopeje të madhe. Shumë herë nëna Fidajete i kishte rrëfyer për masakrën çetniko-partizane të vitit 1944 në Bllacë të Shkupit ku u vranë 111 kryefamiljarë bllacjan e në mesin e tyre shumë dajallarë të tij dhe këto rrëfime s`kishte se si t`i harronte ai. Krahas studimeve, Bajram Dernjani bie në kontakt me shtypin klandestin liridashës dhe do të lexoj shumë revista ilegale, si: Zëri i Kosovës, Liria, Pararoja, Armiku na ka në dorë aq sa e lejojmë ne vetë, trakte, libra, fletushka e proklamata të ndryshme, duke përfshirë edhe Projektprogramin dhe Statutin e Organizatës ku tanimë vepronte. Në Prishtinë ishte në kontakt ilegal me studentët patriot, si Menduh Kaloshin, Gafurr Lumën e Remzi Elezin, ndërsa në Han të Elezit bashkëpunon me Shaban Çupin, Naser Dernjanin, Sejdi Dernjanin dhe shumë studentë të tjerë në masovizimin e kërkesës popullore për Republikë. Në një vjetorin e demonstratave, pra më 11 mars 1982, Bajram Dernjani mori pjesë në demonstratën e madhe për Republikë në Prishtinë. Edhe ndaj kësaj demonstrate, i tërë arsenali i dhunës jugosllave do të shfryhet mbi demonstruesit paqësor,

por në anën tjetër edhe urrejtja ndaj pushtuesit shtohej dhe më shumë. Megjithatë, aktiviteti atdhetar i Bajram Dernjanit nuk ndalon. Në Han të Elezit arrijnë që bashkë me shokët e tij të zgjerojnë fushën e veprimtarisë në leximin e materialeve të tjera ilegale, shpërndarjen te të tjerët dhe përhapjen kudo dhe me çdo mjet të mundëshëm të kërkesës Kosova Republikë. Bajram Dernjani ishte veprimtari më i dalluar i grupit, ishte i palodhshëm në aktivitetin e tij. Me lëvizjen revolucionare arriti që të ndërlidhë shumë student të trevës së Hanit të Elezit. Në fakt grupi i Paldenicës, që nga viti 1981 kishte vepruar i pavarur dhe rreth vehtes kishin arritur të krijojnë një rreth të caktuar shokësh, ndërsa në nivel teknik kishin arritur të krijojnë edhe infrastrukturën e tipografisë e që më vonë do ta ndihmojnë edhe organizatën. Bajram Dernjani njihte mirë rrjedhën e ngjarjeve dhe ishte i pakompromis në luftë për shtetësinë e Kosovës. Bajram Dernjani mori pjesë edhe në formimin e Komitetit të Rrethit i cili u mbajt më 8 nëntor 1985 në Sllatinë të Lepencit në Kaçanik dhe në këtë nivel organizativ Bajram Dernjani ishte anëtar i kryesisë së ngushtë.
Pas disa vjet veprimi, me zbulimin e organizatës ilegale, më sakt i Komitetit Organizativ, zbulohet edhe veprimtaria ilegale e Bajram Dernjanit, kështuqë më 16 nëntor 1985 arrestohet në fshatin Paldenicë derisa po i

përgatiste dy provimet e fundit të Fakultetit Juridik. Nga UDB-ja i bastiset edhe shtëpia e tij, por materialet ilegale nuk mundën t`i gjejnë pasiqë ato ishin të strehuara nga shoku tjetër i tij Shaban Çupi në një strehimore nëntokësore. Pas arrestimit, për pesë orë me radhë e mbajnë në stacionin policor në Kaçanik nën një presion psiqik prej kah e dërgojnë në burgun e Gjilanit ku edhe fillojnë torturat për zbërthimin e këtij anëtari të dëvotshëm të Lëvizje për Liri.

Rënia e Komitetit Organizativ në Prishtinë më 4 nëntor 1985, kishte ndikuar që të bien edhe shumë Komitete të tjera të Rretheve në gjeografinë shqiptare dhe hetimet e rënda që shtroheshin mbi atdhetarët e arrestuar, bënë që zingjiri i zbulimit të zgjerohet edhe më tej. Hetimet ndaj Bajram Dernjanit ishin të rënda dhe krahas udbashëve kaçanikas që shpirtin kaherë e kishin shitur te sllavët, në hetime merrnin pjesë edhe ish profesorët e tij, të cilët kishin hedhur ditarin shkollor dhe kishin marrë pendrekët dhe arsenalin tjetër të dhunës, me të vetmin qëllim shuarjen e idesë së Kosovës Republikë. Nëpër këto tortura të rënda kaloi edhe i pamposhturi Bajram Dernjani. Në dhomën e burgut në Gjilan, ai qëndron edhe me shokë të tjerë të idealit, si Salih Konjusha, Ismet Ramadanin, Nazmi Llapashticën e Begzat Sinanin për të cilët ruan kujtime të mira edhe sot.

Në qershorin e vitit 1986, Bajram Dernjanin bashkë me shokët e tjerë e transferojnë në burgun e Prishtinës, ku më 9 qershor 1986 fillon procesi gjyqësor kundër 23 shokëve. Ky proçes gjyqësor zgjat rreth një javë ditë dhe Bajram Dernjani dënohet me 5 vite burg. Pas dënimit në tetorin e vitit 1986, nga burgu i Prishtinës e transferojnë në burgun e Zrenjaninit në Vojvodinë, 70 km larg Beogradit. Në këtë burg të rëndë e plotë urrejtje antishqiptare Bajram Dernjani qëndron edhe me shokë të tjerë, si: Ramadan Hazirin, Sali Konjusha, Sylejman Bytyqin, Ramë Bujën, Mehë Ukën, Nusret Pllanën, Enver Ajazin, Islam Kocin, Abdullah Zhegrovën e shumë shokë të tjerë, me të cilët do të merr pjesë edhe në grevat e burgut për shkak të shtypjes së madhe që bënin gardianët serb ndaj të burgosurve politik shqiptarë. Është një odiseadë në vete qëndrimi në burgjet serbe të asaj kohe, dënimi mbetej asgjë në krahasim me dhunën që shtrohej mbi të burgosurit dhe familjen e tyre të cilat detyroheshin kilometra të tëra të udhëtojnë për t`i vizituar bijtë e tyre në burgje. Kështu, vepronte edhe familja e Bajramit, ku në borë e shi, dhe asnjëherë pa iu nda, babai Abdullahu, nëna Fidajetja, vëllau Vehbiu dhe motrat e tij nuk iu ndanë për asnjë vizitë edhe atëherë kur acari kishte mbërthyer edhe hekurin. Më 21 prill të vitit 1990, atëherë kur Jugosllavia Avnojane qartazi po

jepte shpirt, nga burgu i Zrenjaninit lirohet Bajram Dernjani për të vazhduar betejën e lirisë tanimë në rrethana të reja, por me probleme të vjetra. Vërtetë në gjithë Europën Juglindore fitoi demokracia dhe sistemi shumëpartiak, por Kosova ishte nën kthetrat e forta të Serbisë gjakatare, andaj pavarësisht dëshirës së madhe që çështja e Kosovës të zgjidhej paqësisht, Bajram Dernjani këtë nuk e besonte,andaj që nga vjeshta e vitit 1990, ai bie në kontakt me të burgosurin politik Naser Kukën nga Kaçaniku dhe tanimë Heroin e Kosovës, Ismail Raka e Idriz Krasniqin dhe fillojnë të bashkërendisin aktivitetet për rezistencë të armatosur, përkatësisht të formimit të Njësive guerile. Më gjerësisht shih librin e Naser Kukës „ **Nga lëvizja ilegale te UÇK"**. Bajram Dernjani ishte tejet aktiv edhe në grumbullimin e mjeteve materiale për blerjen e armëve, që në vitin 1991 në të cilin aksion përfshihen të gjithë shokët e tij të burgosur të Hanit të Elezit. Armët që sjellte Bajram Dernjani nga vija ushtarake e Naser Kukës, fillimisht strehoheshin te Shaban Çupi, pastaj ato shpërndaheshin nëpër shokë të caktuar. Bajram Dernjani, bashkë me Mehmet Ballazhin, disa armë i marrin edhe nga vija tjetër e furnizimit nga Heset Malsiu që në vitin 1991. Gjatë kësaj kohe u bë edhe evidentimi i potencialit të gjallë ushtarak si dhe u mbajtën kurse për ndihmë të parë. Krahas aktivitetit

ilegal, Bajram Dernjani ishte aktiv edhe në jetën legale të subjekteve politike që vepronin në atë kohë si në LDK e sidomos në Këshillin për Financim, ku Bajram Dernjani që nga themelimi ishte kryetar i këtij Këshilli. Krahas kësaj, gjatë rezistencës paralele ndaj pushtuesit, Bajram Dernjani më 24 qershor 1993 emërohet edhe nënkryetar i Qeverisë komunale në Kaçanik, ndërsa kryetar u emërua Maksut Hoxha. Menjë fjalë Bajram Dernjani ishte kudo ku frymonte ideja e çlirimit, bashkimit dhe e lirisë. Në këto rrethana, aktiviteti i Bajram Dernjanit bie në sy të pushtuesit serb dhe duke i vërejtur lëvizjet e tyre, Bajram Dernjani detyrohet të largohet nga Kosova në tetorin e vitit 1993 dhe vetëm disa orë pas largimit nga Kosova, policia serbe e kërkon Bajram Dernjanin në shtëpinë e tij. Fillimisht vendoset në Gjermani e më pastaj në Belgjikë ku krahas punëve të rënda fizike, Bajram Dernjani aktivitetin e tij e vazhdon në perëndim duke marrë pjesë në demonstrata, takime e organizime nga më të ndryshme. Në Belgjikë në mënyrë organizative vepron në kuadër të Këshillit të LKÇK-së (Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës) të cilin Këshill e udhëhiqte Shukri Bejta, kryetar, Bajram Kosumi ishte nënkryetar, kurse Bajram Dernjani u zgjodh sekretar, ndërsa Blerim Çunaku, arkatar.

Bajram Dernjani ishte tejet aktiv në Fondin çlirimtar „Vendlindja Thërret", duke e ndihmuar luftën e UÇKsë gjithanshmërisht deri në çlirimin e plotë të Kosovës dhe i tërë aktiviteti faktohet edhe nga Vërtetimet dhe Falënderimet që i ka marrë nga organet kompetente ushtarake. Në vitin 2022, u nderua edhe me Mirënjohje nga Shoqëria „Lëvizja". Bajram Dernjani jeton e vepron edhe sot në Belgjikë, bashkë me familjen e tij, por gjithnjë me sy e zemër nga Kosova, për të cilën dha shumë. Bajram Dernjani ishte dhe mbeti kryengritësi i pamposhtur në trevën e Hanit të Elezit, mbeti një trim me shum shokë, i dashur dhe i respektuar nga të gjithë.

Shaban Çupi është i lindur më 2 janar 1961 në fshatin Paldenicë, të Hanit të Elezit. Ka të kryer Fakultetin e Edukimit dhe në arsim punon nga viti 1980. Me veprimtari ilegale politike fillon të merret nga viti 1981 sepse siç thoshte Hanibali *ose duhej ta gjenim ose ta bënim udhën*, andaj ishin të mjaftueshme demonstratat e pranverës së vitit 1981 për të hapëruar në rrugën e lirisë. Bashkë me shokët e tij: Bajram Dernjanin, Naser Dernjanin e Sejdi

Dernjani formojnë një grup ilegal i cili me mjete të ndryshme propagandistike, vepron në përhapjen e kërkesës politike Kosova Republikë. Lexojnë trakte të ndryshme, fillimisht nga Fronti Nacionalçlirimtar i Kosovës dhe i shpërndajnë në njerëz të caktuar. Lexojnë dhe i shpërndajnë gjashtë numra të revistës ilegale *Liria*, shumë numra të *Zërit të Kosovës*, materialin *Armiku na ka në dorë vetëm aq sa e lejojmë ne vet*, *Projektprogramin* dhe *Projektstatutin* e organizatës, librin *Titistët*, revistën *Pararoja*, komente nga *Zëri i Popullit* rreth ngjarjeve në Kosovë e materiale të tjera legale e gjysëmlegale. Më vonë bien në kontakt edhe me shokë të tjerë në Kaçanik si me Remzi Elezin, Gafurr Lumën, Remzi Krrabën, ku edhe formojnë Komitetin e Rrethit për Kaçanik, ndërsa grupi i Paldenicës, në këtë Komitet përfaqësohej nga Bajram Dernjani, si vij, frymë dhe ideologji e Gafurr Lokut. Komiteti i Rrethit në vijë vertikale ishte i ndërlidhur me Komitetin Organizativ, dhe në Sekretariatin e kësaj organizate ishin personalitete tanimë të dëshmuar në histori, si: Fehmi Lladrovci, Xhavit Haziri, Xhabir Morina, Bashkim Mazreku e Bajram Limani,...dhe shtrijnë edhe më shumë ndikimin politik në trevën e Hanit të Elezit, duke mbjellur kudo farën e lirisë dhe të çlirimit. Veprimtaria e Komitetit Organizativ zbulohet më 4 nëntor 1985 e për pasojë zbulohet edhe Komiteti

i Rrethit për Kaçanik, në mesin e tyre edhe Shaban Çupi i cili arrestohet një muaj më vonë, më 4 dhjetor 1985. Në gjyqin e Prishtinës dalin 23 shokë dhe dënimi më i lartë ishte 11 vite, ndërsa Shaban Çupi dënohet me 4 vite e 6 muaj burg. Brenda kësaj kohe, në Kosovë u zhvilluan ngjarje të mëdha. Shteti hegjemonist serb, suprimoi autonominë e Kosovës dhe miratoi kushtetutën e tankeve, burgosjet vazhdonin, por edhe rezistenca rritej. Si pasoj e torturave, në tetorin e vitit 1986 vdiq Metush Krasniqi, në majin e vitit 1989 vritet veprimtari Ali Ajeti dhe ngritet Çeta e Llapit. Lëvizja në aspekt organizativ ishte ngritur në nivel të duhur, demonstratat ishin masive dhe të përgjakshme e si pasojë në nëntor të vitit 1989 vriten krerët e Lëvizjes Popullore të Kosovës, Afrim Zhitia e Fahri Fazliu. Minatorët ngujohen në horizontet e thella të Trepçës. Në anën tjetër, fillon pajtimi i gjaqeve dhe lejohet sistemi shumëpartiak, ngjarje këto gjithsesi me peshë historike. Në arenën ndërkombëtare, bie Muri i Berlinit që kishte ndarë në dy pjesë Gjermanin për 50 vjet, ndërsa socializmi si sistem shoqëror, kolapsoi. Në këto rrethana që po zhvilloheshin, Shaban Çupi ishte në fund të kryerjes së burgut të parë dhe nga burgu i Gurakocit lirohet më 23 prill 1990. Në vitin 1991, krahas aktivitetit legal në subjektin politike të asaj kohe (LDK), vepronte ilegalisht me shokët e tij të

burgosur si Gafurr Loku, Bajram Dernjani, Mehmet Ballazhi, Nexhat Ballazhi, Ibrahim Curri, Sejdi Dernjani, Selman Currin, në mbledhjen e mjeteve materiale për blerjen e armëve për rezistencë të armatosur. Bajram Dernjani si arterja kryesore e grupit, në kontakt me Naser Kukën dhe tanimë Heroin Ismail Rakën arrinë t`i siguroj disa armë, qëllimi i të cilit ishte formimi i Njësiteve Guerile. Përshkak të bastisjeve të shumta, në qershorin e vitit 1995, largohet për në Shkup ku qëndron 13 muaj. Për disa muaj qëndron në spitalin e Tiranës, ku edhe bëhet operacion nga tumori në kokë. Rikthehet sërish në Kosovë (shtator 1996) dhe aktivitetin e jep pranë KMLDNJ në Han të Elezit. Është pjesmarrës i të gjitha protestave kundër dhunës dhe shtypjes serbe. Në majin e vitit 1998, bie në kontakt me njësitin e UÇK në Han të Elezit i cili fillimisht arriti t`i siguroj disa armë. Me zbulimin e grupit, ku një pjesë arrestohet e pjesa tjetër arrinë të del në mal në Puset e Nikës, e ndihmon njësitin me mjete materiale, me armë e municion dhe në masovizimin e luftës për liri. Në kuadër të UÇK-së kishte detyrën e përgjegjësit për Marëdhënie Civile Ushtarake dhe nga kjo pozitë arrestohet më 16 mars të vitit 1999. Përkundër arrestimit të tij, pesë anëtarë të familjes ishin pjesëtarë të UÇK-së. Është përjetues edhe i masakrës serbe ndaj të burgosurve shqiptarë në

Dubravë të Istogut ku u vranë 117 të burgosur e mbi 200 mbetën të plagosur. Më 10 qershor 1999, si peng lufte, dërgohet bashkë me shokët e tjerë në Nish të Serbisë. Nga burgu i Nishit lirohet pas 17 muaje, më 10 gusht 2000. Duke llogaritur edhe burgun e parë, mban gjithësejt gjashtë vite burg. Në vitin 2001, ndihmon luftën e UÇ Kombëtare në Maqedoni me mjete materiale dhe furnizim me mjete lufte. Pas formimit të komunës së Hanit të Elezit në vitin 2005, në dy mandate ishte këshilltar i PDK-së pranë Kuvendit Komunal, ndërsa në vitin 2009 edhe kryesues i Kuvendit. Për disa vite ishte korespondent i Agjencisë së lajmeve Kosovapress në Prishtinë. Nga viti 2006 deri në vitin 2008 punon si Zyrtar për kulturë, rini e sport. Nga viti 2010 sërish kthehet në arsim ku punon edhe sot. Nga viti 2001 deri në vitin 2023 boton 19 libra, kryesisht me tema nga lufta jonë çlirimtare, duke hulumtuar edhe vlerat historike, kulturore dhe etnografike të trevës së Hanit të Elezit. Nga viti 2007 deri në vitin 2021 ishte kryetar i Shoqatës së të burgosurve politik në Han të Elezit. Është nderuar me Mirënjohje nga komuna, institucioni arsimor, Shoqata e të Burgosurve Politik dhe Shoqëria „Lëvizja".Jeton dhe vepron në fshatin e lindjes.

Sejdi Dernjani (1950- 2021)

Sejdi Dernjani është i lindur më 29 mars 1950 në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Krahas shkollimit fillor ka të kryer edhe shkollën e mesme në drejtimin elektricist në Kaçanik. Në vitin 1968 punësohet si elktricist në fabrikën e çimentos Sharr. Edhepse të rritur në rrethana të rënda ekonomike, Sejdiu dhe vëllezërit e tij i dhanë rëndësi të madhe arsimimit. Për një emancipim më të madhë shoqëror, krahas punës, nga viti 1974 ishte edhe anëtar i SHKA „Sharri'' në Han të Elezit dhe në kuadër të shoqërisë udhëheqte grupin e folkloristëve. Arrijnë të japin një numër të konsiderueshëm koncertesh si në Kosovë, si në Maqedoni. Shpesh herë ka ndodhur që në koncerte, Sejdi Dernjani të dilte nga repertori i këngëve që atë botë duheshin të vërtetoheshin nga organet pushtetore. Si pasojë e këtyre shkeljeve të shpeshta e

përjashtojnë edhe nga Shoqëria kulturore artistike. Ishte përkrahës i demonstratave për Republikën e Kosovës të vitit 1981. Për realizimin e këtij qëllimi, bashkë me shokët e tij Bajram Dernjanin, Shaban Çupin e Naser Dernjanin, formojnë grupin atdhetar të Paldenicës duke ndikuar edhe te të tjerët në masovizimin e idesë së lirisë. Me zbulimin e veprimtarisë së grupit, zbulohet edhe Sejdi Dernjani ku me 23 dhjetor 1985 arrestohet. Hetimet ndaj tij zhvillohen në burgun e Gjilanit, ku edhe dënohet me 60 ditë burg. Pas burgut, punën sërish e vazhdon në fabrikën e çimentos, por gjithnjë i përcjellur nga UDB. Si pasojë e aktivitetit të tij politik, përjashtohet edhe nga Lidhja e Komunistëve, sepse siç thuhej në dokumentet e tyre, Sejdi Dernjani kishte thyer rendin kushtetues dhe kishte mohuar vlerat e revolucionit jugosllav. Shtëpia e tij, ishte një fole e ngrohtë për të gjithë dashamirët e atdheut. Aty përcillej rregullisht RTSH dhe dëgjoheshin komente nga më të ndryshmet rreth ngjarjeve në Kosovë, që vinin nga Shqipëria. Me themelimin e grupit letrar në Han të Elezit (1991), ishte anëtar i këtij grupi dhe në fletushkën e grupit ka botuar disa poezi. Në vitin 1991 ishte një ndër mbledhësit e mjeteve materiale për armatim dhe strehues i armatimit që sjellnin shokët e tij, përkatësisht ish i burgosuri politik, Bajram Dernjani. Ishte një mjeshtër i

dalluar e për rrjedhojë konstruktoi edhe bomba dore të mbushura me barot. Sejdi Dernjani, nga forcat policore serbe arrestohet edhe më 16 mars 1999 dhe bashkë me të arrestuarit e tjerë dërgohet në Ferizaj ku edhe torturohet rëndë. Pas dy dite, lirohet nga qendra e sigurimit në Ferizaj, por detyrohet të kërkoj ndihmën mjekësore në Tetovë. Sejdi Dernjani ishte motivues i gjithanshëm i progresit, arsimimit, emancipimit dhe i luftës për liri, andaj shumë anëtarë të familjes së tij ishin edhe pjestarë të UÇK-së.

Krahas veprimtarisë atdhetare, Sejdi Dernjani shquhej si një instrumentalist i dalluar i çiftelisë. Që nga koha kur e përjashtuan nga Shoqëria Sharri (1981), Sejdiu filloi të merret me drugdhendje duke ndërtuar instrumente të ndryshme muzikore që nga çiftelia, sharkia, fyej nga më të ndryshëm, zurla, okarinën ilire, gajden e mbi të gjitha violinën dhe me të gjitha këto pas tri dekadave pune me përkushtim, arriti që në shtëpinë e tij të ngris një muze të veglave muzikore, një trashëgimi kjo e rrallë dhe me mjaftë vlera etnomuzikore. Është karakteristike se në çdo instrument të punuar, me pedantëri ka vijëzuar figura me vlera vernakulare, gjithsesi simbolika me interes për brezat aktual dhe ato që do të vijnë. Sejdi Dernjani ndërroi jetë në spitalin e Ferizajt më 30 prill 2021 në

moshën 71 vjeçare, duke lënë prapa një veprimtari të begatë kombëtare.

Naser Dernjani është i lindur më 5 shkurt të vitit 1959 në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Ciklin e ulët të fillores e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa të lartin në Han të Elezit. Me kryerjen e shkollës fillore, mësimet i vazhdon në Shkollën Normale të Prishtinës nga viti 19741978 dhe ishte një nxënës i dalluar në mësime. Me përfundimin e Shkollës Normale, studimet i vazhdon në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe ishte student i dalluar. Në arsim punësohet në shtatorin e vitit 1980 dhe fillimisht punon në Han të Elezit, pastaj në Puset e Nikës dhe më në fund në fshatin Paldenicë. Babai i tij Selami ishte korier shkolle, por në vitin 1956 në kohën e aksionit të armëve, ishte torturuar rëndë nga UDB-a e Rankoviqit dhe nga këto tortura deri në vdekje ka pasur probleme shëndetësore. Vuajtjet dhe stigmatizimet që injoranca shprehte ndaj babait të tij, dhe situata e përgjithshme në Kosovë, Naserit do t`i skaliten thellë në kokë, andaj demonstratat e vitit 1981 i ngjasonin tokës së etur për ujë. Këto demonstrata

ishin ajo flaka e lirisë për shembjen e Jugosllavisë 22 milionëshe, kështuqë Naseri që nga viti 1981, bashkë me shokët e tjerë në fshatin e tij të lindjes, formojnë grupin ilegal që vepronte për Republikën e Kosovës, duke masivizuar idenë e lirisë gjithandej. Naseri kishte një bibliotekë të pasur me libra, shumë karakteristike për kohën. Me zbulimin e Organizatës ku vepronin, zbulohet edhe Naser Dernjani dhe me 23 dhjetor 1985 arrestohet. Hetimet i kryen në burgun e Gjilanit ku edhe e dënojnë me 60 ditë burg, të cilin edhe e vuan. Si pasojë e këtij aktiviteti ilegal politik, puna në arsim i ndalohet. Krahas ndalimit të punës edhe pas vuajtjes së dënimit, Naser Dernjani keqtrajtohet nga organet e ndjekjes, duke e marrë shpesh në pyetje, duke e kërcënuar dhe shantazhuar në vazhdimësi. Për mbijetesë, detyrohet që të punoj si punëtor krahu në Beograd e Shibenik të Kroacisë. Në arsim rikthehet vetëm pas shembjes së sistemit jugosllav, pra në shtatorin e vitit 1990. Në fshatin e tij të lindjes punon deri në dhjetor 1992 ku edhe migron në Zvicërr ku është edhe sot. Është i martuar dhe babai i tre fëmijëve. Gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, vëllau Imzani dhe motra e tij Diana, ishin pjesëtarë të Brigadës 128 të UÇK së.

Ferat Curri është i lindur më 16.3.1966 në fshatin Dërmjak të Hanit të Elezit. Pasi shpërngulet nga ky fshat, vendoset në Han të Elezit ku kryen edhe shkollën fillore. Të mesmen si automekanik e përfundoi në Kaçanik. Pas demonstratave të vitit 1981, shovenizmi serb ishte gjithkah në
ndjekje të shqiptarëve, në veçanti në Armatën jugosllave e cila quhej edhe popullore (APJ). Kjo armatë u bë ferr për djalërinë kosovare dhe janë me qindra shqiptarë që do të dënohen me akuza improvizuese, ndërsa nga viti 1981 deri në vitin 1990 u vranë 122 ushtarë shqiptarë.

Një ftesë për shërbim të dhunshëm pranë kësaj armate fatkeqe e mori edhe Ferat Curri. Shërbimin ushtarak e fillon në Mostar të Bosnjes. Pasiqë e kryen shërbimin, në vend që të vie në shtëpinë e tij, Ferat Curri arrestohet bashkë me 6 shokët e tij. Arrestohet më 10 korrik 1986. E burgosin në burgun ushtarak në Sarajevë ku hetimet zgjatën rreth 6 muaj ditë. Ferat Curri bashkë me shokët e tij ngarkohen për formim të grupi ilegal brenda ushtrisë jugosllave, për marrje të armëve, për dëgjim të Radio Tiranës e të ngjajshme dhe dënohet për dy vepra: Bashkim për veprimtari

armiqësore nga neni 136 dhe marrje të armëve nga neni 223. Për këto dy vepra nga Gjykata ushtarake e Sarajevës, dënohet me 6 vite burg, por shkalla e lartë ushtarake ia zbret dënimin në 4 vite e 6 muaj. Mban gjithsejt 3 vite e 6 muaj burg. Lirohet nga burgu i Foçës.

Megjithëse, për Ferat Currin, janë pyetur edhe shokë të tjerë, drejtpërdrejt a tërthorazi, si Raif Qela, Skender Basha, Musli Prebreza…, fjalët e të cilëve kryesisht kishin një emërues të përbashkët cilësimi, ne u përcaktuam si për një gjedhe më shprehimore në rrefimet e dy të burgosurve, për një kohë të konsiderueshme bashkëvuajtës të Feratit, Gëzim Hagjimusa dhe Ibush Vishi.

Gëzim Haxhimusa, thotë:

- Sot, kujtoj me nostalgji si e njoha Ferat Currin. Mbaj mend mirë forcën e karakterit të tij dhe qetësinë e tij që aq hijshëm e mbante më vete. Ferati ishte një burrë që kishte pak fjalë dhe ishte një dëgjues i vëmendshëm. Që nga ditët e para, kur u takuam në burgun e Foçës, në Bosnjë, gjetëm mirëkuptim me njëri-tjetrin. Ai shumë mirë e kuptonte edhe gjendjen time, pasi që edhe ai ishte i dënuar nga shërbimi ushtarak i ishJugosllavisë. Sikundër edhe unë shpirtin e tij që e kuptoja po aq natyrshëm e aq drejt.

Vëreja se si Ferati vuajtjen që mbante në supe e dhunën psikike e largonte saherë që bënte ushtrime fizike. Dhe, ushtronte vazhdimisht… Dukej sikur në ditët kur ishte më keq, fizikisht bëhej më i fortë. Prandaj dallohej për fizikun më të mirë në mesin e të gjithë të burgosurve aty. Në të vërtetë, Ferat Curri ishte shumë modest, ndër më modestët në mesin tonë aty.

Gjithmonë do ta kujtoj të tillë: burrë i fortë, si nga brenda, dhe nga jashtë! Ibush Vishi, ndërkaq, evokon:

- Në burgun hetues të Sarajevës, kryeqytet i Bosnjës, ku ndërkohë qëndruam rreth shtatë muaj të '86-7-tës, rëndom përmendnin se nga aty mund të na transferonin në burgun e Zenicës a të Foçës, por jo domosdoshmërisht, sepse kishte edhe burgje të tjera gjithandej... Sidoqoftë, ishte e sigurtë se kudo që të shkonim do të gjenim edhe shqiptarë, ngaqë, jo vetëm të brezit tonë a pas nesh, shqiptarët gjithmonë ishim si të destinuar për burgje. Jetë robi, ani se kryengritës! Dhe, ne na dërguan në Foçë. Si të porsashkuar aty ishim: Fadil Lepaja, Rrahman Dini, Musli Prebreza, Ibush Vishi, Xhevat Elezkurtaj… Ku në fillim, për nja një muaj ditë, na mbajtën në karantinë. Ndërkohë që kishin qenë dhe vinin edhe plot të tjerë… Pra, për fat të keq, aty gjetëm dhjetëra shokë shqiptarë, shumica të burgosur politikë, që tashmë po vuanin edhe "burgun e lirë". Fatkeqësisht, ndonëse ai numër i madh

shqiptarësh në burgje jo vetëm aty, për ne ishte edhe një si ogur i mirë se liria kishte nisur të vinte, gjë që për këtë besonim idealisht.

Një ditë, jo vetëm për procedurë, na erdhi edhe psikologu i burgut, një mashkull si i bëshëm. Dhe, jo me pyetje të posaçme për secilin nesh, po pa shkas e si nga reja, vetëm me një fyerje për të gjithë (në serbisht): "Përse jeni kaq të pafytyrë?!" Por që edhe ai po ashtu mori vetëm një përgjigje, nga Fadil Lepaja, një për një: "Bezobrazan si ti!" ("I pafytyrë je ti!")

Psikologu, u kthye si i plagosur, sado edhe si me mision të kryer, duke vërtetuar shpirtin rebelues!

… E, megjithëse ne ishim ende në karantinë, shumica e të burgosurve shqiptarë "vidheshin" disi të na vinin edhe për ndonjë vizitë mes grilash: përshëndetje të shkurtra, ndonjë lëng, ndonjë ëmbëlsirë, inkurajim e një fjalë të mirë…

Ndër ata shokë që po na vizitonin, gjithashtu ishte edhe Ferat Curri. Një djalë shumë themeli, si thotë populli. Më vonë do të merrnim vesh se ky rridhte nga një familje tamam bujare e Hanit të Elezit.

E vërteta, Ferati, ky djalë i ri, ishte dënuar me disa shokë si vet. Ishte dënuar në një proces gjyqësor ushtarak të asaj kohe, derisa po vuanin atë shërbim famëkeq. Kurse ndër akuzat ndaj tyre, ishte edhe "e dhëna" se paskëshin shpërdoruar apo grabitur armë,

disa pushkë, nga depot ushtarake, ndërkohë që gjoja për fatin e atyre armëve tutje nuk dihej! Çka në kuptim të rrethanave që krijoheshin me mënyrën e mirënjohur soldateske-policore gjatë hetimeve, vështirë të kuptohej mosadresimi i vendndodhjes më tej i atyre armëve…

Sidoqoftë, nga bisedat me Feratin, sado i vetëpërmbajtur që ka qenë, megjithatë sikur vërehej një dëshirë a dashuri e tij për armët. (Mbase e kishte edhe edukatë familjare.) Mirëpo, për këtë supozim disi e jepte edhe një shkas: shfaqej i pasionuar për kalitjen fizike. Madje për këtë po ndikohej edhe nga disa shokë të tjerë ushtarakë shqiptarë, po ashtu të dënuar politikë në procese gjyqësore ushtarake, që edhe ashtu e kishin për vokacion këtë punë e jo vetëm si pasion sportiv. Ferati ishte sportist, ku më me zell ushtronte peshat. Nga virtyti, Ferat Curri ka qenë djalë i mirë, i dashur, i cili sikur nuk ka ditur të rëndojë kënd. Ka qenë fjalëpak, por shumë i patrembur dhe si i tillë edhe shumë besnik. Ishte edhe punëtor më se i vyer, sa edhe mirëkuptues i gjendjes së njerëzve në nevojë dhe bëmirës ndaj tyre. Madje, në kuptimin njerëzor, pjekuria e tij peshonte pjekurinë e shumë njerëzve me përgatitje. Kurrë nuk shërbehej me thashetheme. Thjesht, këto ishin tipare të theksuara të karakterit të Feratit. E përjetoi lirinë e Kosovës, por nuk e gëzoi

gjatë, e privoi një sëmundje e rëndë! Vdes nga kanceri në moshën 48 vjeçare, në vitin 2014.
Ferat Curri ishte i martuar dhe ka lënë katër fëmijë.

Ibrahim Curri është i lindur më 24.02.1967 në fshatin Dërmjak të Hanit të Elezit. Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmen në Gjimnazin e Kaça-nikut. Pas kryerjes së shkollës së mesme, studimet i vazhdon në Prishtinë në Fakultetin Elektroteknik. Gjatë kësaj kohe, bashkë me shokët Heset Malsiu, Hisret Kyçyku, Mehmet Ballazhi, Nexhat Ballazhi e Agim Dauti formojnë Grupin ilegal Politik „Kushtrimi'', qëllimi i të cilit ishte që Kosova të fitoj statusin e Republikës. Grupi ishte mjaft aktiv në leximin dhe shpërndarjen e materialeve ilegale, pamfleteve dhe shkrimin e parullave nga më të ndryshme me të vetmin qëllim, masovizimin e idesë së lirisë dhe çlirimin e atdheut nga pushtuesi serb. Grupi zbulohet nga UDB në shtatorin e vitit 1987 dhe Ibrahim Curri nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, dënohet me tri vite burg, të cilin edhe e vuan në Gjilan dhe në burgun e Dubravës. Gjatë burgut, arrinë të njohin dhe kontaktojnë edhe me shum shokë të tjerë liridashës,

duke marrë edhe një përvojë më të madhe në luftën për liri.

Për një dekadë me radhë, treva e Hanit të Elezit ishte ndjekur e përndjekur nga pushtuesi. Ishin arrestuar, torturuar, izoluar e dënuar shumë veprimtarë, dhe në përgjithësi ishte krijuar një atmosferë frike në popull. Ishte çështje e madhe organizimi i një demonstrate publike, aq më tepër kur nuk ishte organizuar kurr një e tillë. Por, me lirimin nga burgu të Ibrahim Currit dhe shokëve të tij si Mehmet Ballazhi dhe Nexhat Ballazhi, ata nga burgjet kishin sjellur një eksperiencë jo të vogël dhe ishte momenti për të shpërthyer ky mllef i mbledhur për një dekadë, së paku nga viti 1981 e këndej. Në anën tjetër, Lëvizja Popullore e Kosovës, nëpërmjet *Rrugës së Lirisë* të janar-shkurtit 1990, nën moton: ***Jo, jo Serbi, nuk do të jesh perandori***, bënte thirrje publike që kudo dhe në çdo formë rezistenca për liri të rritej.

Andaj në këto rrethana, Ibrahim Curri, bashkë me shokët e tjerë, që kishin dalur edhe më fortë nga burgjet, ishte njëri ndër organizatorët e demonstratës së parë në Han të Elezit e cila u mbajt më 26 janar 1990.

Si si u zhvillua kjo demonstratë, ish i burgosuri politik Ibrahim Curri rrëfen:

Ne vetëm sa patëm dalur nga burgu, dhe si të tillë, situatës po i ktheheshim me një përvojë relativisht të

mirë. Në burgje takuam, njohëm dhe u shoqëruam me shumë atdhetarë që dergjeshin burgjeve për të shtrenjtën Kosovë dhe njëkohësisht shkëmbyem edhe përvoja, sidomos rreth mënyrës së organizimit të demonstratave.

Brumi i demonstratës kishte qenë i përgatitur nga dhuna e pushtuesit dhe rrethanat e asaj kohe. Ne këtë e vërejtëm nga kontaktet që kishim me njerzë. Unë (Ibrahim Curri), Mehmet Ballazhi dhe Nexhat Ballazhi, që të tre të dënuar në një proces gjyqësor të pushtuesit që nga viti 1987, morëm vendim që të kontaktojmë shumë njerzë, por në rrethe të ngushta, me vëllezër, kusherinjë, shokë e farefis dhe krijuam bazën e demonstratës, krijuam bërthamën e sajë. Vendosëm për datën e demonstratës, vendin se ku duhet të filloj ajo si dhe kërkesat politike që duhej t`i brohorisnim.

Kohën për fillimin e demonstratës e ndërlidhëm me kohën kur punëtorët dilnin nga fabrika, me qëllim të masovizmit të sajë, ndërsa vendin e tubimit e vendosëm te stacioni i trenit që më leht të armatoseshim me gurë.

Kërkesat fillestare ishin: Duam punë! Duam Drejtësi! Liri, Barazi! Kush s`bashkohet është tradhëtar! dhe në fund, Kosova Republikë!

Kurrë nuk mund ta harroj momentin kur u bëmë bashkë për të filluar demonstratën, ishte një ndjenjë vëllazërore, një solidaritet i pashpjegueshëm. Në fillim ishim 30-40 vetë, por kur u nisëm në drejtim të qendrës, masa rritej. Një numër i caktuar punëtorësh, ata që kishin një ndjenjë më të formuar kombëtare, u bashkangjitën në demonstratë, ndërsa te të tjerët ende sundonte frika. Këto demonstrata vazhduan derisa ndërhyni policia special me gaz lotësjellës e me shkrepje të armëve. Pavarësisht burgosjeve, demonstrata arriti qëllimin e vet fundamental, populli filloi ta humbë frikën të cilën pushtuesi e kishte ngulitur thellë në qenien shqiptare, kujton Ibrahim Curri njëri nga organizatorët e kësaj demonstrate, të janarit 1990.

Kjo demonstratë ishte masovike dhe si e tillë prodhoi një situatë kryengritëse dhe ka zgjatë disa ditë. Në këtë demonstratë kanë marrë pjesë mbi 300 demonstrues, derisa për shuarjen e saj, intervenon edhe policia speciale, duke arrestuar edhe dhjetëra demonstrues. Në këtë valë arrestimesh, natyrisht që kërkohej edhe organizatori i saj, Ibrahim Curri. Për t`i ikur arrestimit të dytë, kalon në arrati dhe më pastaj në Gjermani ku është edhe sot.

Veprimtarinë atdhetare, Ibrahim Curri e vazhdon dendur edhe në mërgim, ku ishte mjaftë aktiv në

demonstratat që zhvilloheshin në mbrojtje të Kosovës, ishte mjaft aktiv edhe në tubime e organizime nga më të ndryshmet që i organizonte Lëvizja Popullore e Kosovës. Ishte në shërbim të UÇK-së dhe kontribues i Fondit ,,Vendlindja Thërret'' në Gjermani. Krahas këtyre kontributeve Ibrahim Curri ishte edhe njëri nga paguesit e telefonit satelitor të Brigadës 164 ,,Gafurr Loku'' të UÇK-së në Han të Elezit, ndërsa vëllezërit e tij, pjestarë të luftës së lavdishme të UÇK-së.

Mehmet Ballazhi është i lindur më 9 prill 1967 në fshatin Puset e Nikës. Më vonë shpërngulet në Han të Elezit ku edhe e kryen shkollën fillore. Të mesmen e vazhdon në Kaçanik dhe i frymëzuar nga ndjenjat atdhetare që nga shkollimi i mesëm fillon të merret me veprimtari

ilegale për Kosovën Republikë.

Mehmet Ballazhi bashkë me shokët e tij si; Ibrahim Currin, Nexhat Ballazhin, Heset Malsiun, Agim Dautin e Hysret Kyçykun, që në vitin 1985 formojnë grupin ilegal ,,Kushtrimi'' dhe në mënyrë të organizuar merren me veprimtari klandestine e cila nga ligjet e pushtuesit ndëshkohej rëndë.

Lexojnë e shpërndajnë materiale ilegale nga më të ndryshmet, mbajnë mbledhje dhe shkruajnë parulla për të rritur numrin e atdhedashësve. Pas përfundimit të shkollës së mesme, merr ftesën për shërbim të dhunshëm ushtarak në armatën jugosllave.

Derisa ishte në shërbimin ushtarak, zbulohet organizata ku vepronin, andaj në shtator të vitit 1987 arrestohet. Hetimet ndaj Mehmetit zhvillohen në burgun e Gjilanit. Është karakteristike, se Mehmet Ballazhin (edhe pse në moshë të re) mbi katër muaj me radhë e fusin të vetëmuar në një qeli burgu, e krahas kësaj çdo natë merrej në pyetje në kthinat e UDB-së. Pas disa muaj hetime e dërgojnë bashkë me shokët e grupit në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës dhe e dënojnë me 2 vite burg. Pas shqiptimit të dënimit e rikthejnë sërish në burgun e Gjilanit, e më pas e transferojnë në burgun e Dubravës ku njihet edhe me shum shokë të tjerë. Nga burgu lirohet në shtatorin e vitit 1989 në kohën kur në Kosovë zhvilloheshin demonstrata të fuqishme, të cilat i organizonte LPK. Në këto rrethana Mehmet Ballazhi, Ibrahim Curri dhe Nexhat Ballazhi arrijnë të organizojnë demonstratën e parë në Han të Elezit më 26 janar 1990 ku marrin pjesë mbi 300 vetë. Demonstratat ishin të fuqishme dhe zgjatën rreth një javë. Në këto demonstrata, Mehmet

Ballazhi arrestohet sërish dhe dënohet me 30 ditë burg të cilin edhe e vuan në burgun e Dubravës.
Viti 1990 ngërthen ngjarje nga më të ndryshme dhe në të gjitha këto ngjarje Mehmeti me shokë ishte aktiv. Në vitin 1991, bashkë me shokë të tjerë të ilegales, mbledhin mjete materiale për blerjen e armëve, qëllimi i së cilës ishte rezistenca e armatosur. Bashkë me Bajram Dernjanin, arrijnë që disa armë t`i sjellin në Han të Elezit. Në vitin 1991, formon grupin letrar „Luigj Gurakuqi" dhe njëherit ishte kryetar i këtij grupi, grup i cili krahas veprimtarisë poetike merrej edhe me punë të tjera mobilizuese. Kur pushtuesi mbylli objektet shkollore, shtëpia e tij u përdor për zhvillimin e mësimit shqip. Në vitin 1993 mërgon në Gjermani ku punon si punëtor krahu e në anën tjetër veprimtarinë e tij politike e zhvillon në kuadër të LPKsë. Merr pjesë në të gjitha demonstratat që zhvilloheshin në Gjermani në mbrojtje të Kosovës dhe atje njihet edhe me tanimë heroin e Kosovës, Fehmi Lladrovcin. Kur u formua Fondi „Vendlindja thërret" Mehmet
Ballazhi ishte pjesë e këtij fondi, por kur në Puset e Nikës formohet Njësiti i UÇK-së, e lë punën në Gjermani dhe nga korriku i vitit 1998, kthehet në Puset e Nikës si pjesëtar i UÇK-së. Në Kosovë futet nga Shqipëria me ushtarë të tjerë duke udhëtuar në këmbë

me ditë e netë të tëra dhe në Puset e Nikës solli disa armë. Për të ngritur nivelin e organizimit, nga Puset e Nikës, në nëntor të vitit 1998 kalon sërish në Shqipëri në qendrën stërvitore në Vlanë, ku tanimë një pjesë e ushtarëve të UÇK-së nga Hani Elezit filluan stërvitjet ushtarake. Në këtë qendër stërvitore Mehmeti dha një kontribut të madh në aftësimin ushtarak të të rinjëve që duheshin të ktheheshin në zonën e luftës në Puset e Nikës. Krahas shokëve e farefisit, si pjesë e UÇK-së ishin edhe vëllezërit e tij Ekremi dhe Mehmedaliu. Rënien e bashkëluftëtarëve të tij në Pashtrik më 14 dhjetor 1998 e përjetoi rëndë, ku në mesin e të rënëve ishte edhe Veli Ballazhi.

Në Puset e Nikës, rikthehet më 16 mars 1999, duke u përballur me të gjitha ofenzivat armike të atij viti. Me formimin e Brigadës 164 „Gafurr Loku" të UÇK-së, Mehmet Ballazhi ishte zv/komandant i Brigadës. Gjatë luftës çlirimtare dha një kontribut të madh, si në luftime, si në njohurit luftarake që kishte nga Shqipëria dhe kishte autoritet të pakontestueshëm në mesin e luftëtarëve të lirisë. Krahas luftës, Mehmet Ballazhi deminoi shumë fusha që armiku kishte minuar, duke shpëtuar ku ta dimë sa e sa jetëra njerzish. Me përfundimin e luftës dhe me formimin e TMK-së ishte pjesë e saj në Kaçanik dhe në kuadër të Brigadës 362 „Agim Bajrami" të Trupave Mbrojtëse të Kosovës,

ishte Shef Shtabi. Me fillimin e luftës së vitit 2001 në Maqedoni, ishte pjesë aktive e UÇK-së në Radushë, përkatësisht në Brigadën 115 të UÇK-së. Pas transformimit të TMK-së, Mehmet Ballazhi kalon në pjesën civile të veprimtarisë ku në kuadër të komunës së Hanit të Elezit ishte Drejtor i Drejtorisë së Arsimit.
Mehmet Ballazhi ka kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike në drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prishtinë. Pastaj ka kryer Shkollën e Oficerëve të Karrierës në Akademinë e Mbrojtjes „Hamëz Jashari", si dhe Fakultetin Gjuhë dhe Letërsi Gjermane në Universitetin e Tetovës.
Ka punuar si mësimdhënës pranë shkollës fillore „Ilaz Thaçi" në Han të Elezit.
Mehmet Ballazhi në jetën kulturore dha një kontribut të çmuar edhe në SHKA „Sharri" ku për dy vite me radhë ishte edhe kryetar i kësaj Shoqërie dhe pati mjaft suksese. Aktivitetin e tij politik, Mehmet Ballazhi e zhvillon në kuadër të PDK-së në Han të Elezit ku ishte edhe kryetar i kësaj dege. Në kuadër të Qeverisë së Kosovës ishte edhe këshilltar i ministrit për Mirëqenie Sociale e më pas edhe në Bordin e Hekurudhave.
Në mandatin 2017- 2021 ishte edhe shef i grupit të asambleistëve të PDK-së pranë kuvendit komunal të Hanit të Elezit. Në nëntorin e vitit 2021, në zgjedhjet lokale të këtij viti, zgjedhet kryetar i komunës së Hanit

të Elezit, detyrë të cilën e zhvillon edhe sot. Ka botuar librin „Nën flamurin e UÇK-së", libër ku pasqyrohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare. Jeton në Han të Elezit.

Nexhat Ballazhi është i lindur më 21.5.1967 në fshatin Puset e Nikës të komunës së Hanit të Elezit. Meqenëse familja e tij shpërngulet nga fshati për në Lagje të Re të Hanit të Elezit, shkollën fillore e kreu në këtë qytezë. Fati e deshi që në shkollën fillore për mësues të kishte Islam Rekën nga Kaçaniku, një mësues që rrjedhte nga një familje atdhetare, ku babai i tij ishte i dënuar me vite të gjata burgu si pjesëtar i NDSH-së.

Në vitin shkollor 1982/83 Nexhat Ballazhi regjistrohet në shkollë të mesme në Kaçanik në drejtimin e kimisë ku pas katër viteve diplomon si laborant kimik. Gjatë shkollimit të mesëm, pavarësisht se të rinjë, jehona e demonstratave të vitit 1981, kishte lënë gjurmë të pashlyeshme edhe në shpirtërat e njomë të këtyre të rinjëve. Arrestimet, burgosjet dhe dënimet drakonike që jepeshin mbi rinin shqiptare, zgjuan shtresa të gjëra popullore. Traktet që shpërndante Lëvizja ilegale për

Republikën e Kosovës, dhe situata e përgjithshme që mbretëronte në Kosovë, ndikuan që edhe Nexhat Ballazhi bashkë me shokët e tij të shkelin në rrugën e lirisë, kështuqë: Nexhat Ballazhi, Mehmet Ballazhi, Ibrahim Curri nga Hani i Elezit si dhe Heset Malësiu, Agim Dauti e Hysret Kyçyku nga Kaçaniku, që në shkollë të mesme, formojnë grupin ilegal politik „Kushtrimi" platformë e të cilit ishte që Kosova të bëhej Republikë.
Ky grup i të rinjëve, ranë në kontakt edhe me shtypin klandestin të kohës, të cilat përveç që i lexonin vet, ua jepnin edhe të tjerëve për lexim, duke i rritur radhët e shokëve gjithandej.
Në marsin e vitit 1987, Nexhat Ballazhit i vie ftesa për shërbim të detyrueshëm ushtarak në armatën jugosllave. E dërgojnë në Zenicë të Bosnjes dhe në shërbim ushtarak qëndron rreth gjashtë muaj ditë, deri në shtator të vitit 1987. Meqenëse zbulohet veprimtaria ilegale e grupit, Nexhat Ballazhi arrestohet në Zenicë më 21 shtator të vitit 1987. Nexhat Ballazhin nga shërbimi ushtarak e bien në burgun hetues të Gjilanit. Pas disa muaj hetime në burgun e Gjilanit, i nxjerrin para gjyqit të Prishtinës, dhe për pasojë dënohen:
Ibrahim Curri me 3 vite
Mehmet Ballazhi me 2 vite
Nexhat Ballazhi me 2 vite

Agim Dauti me 2 vite, ndërsa Heset Malsiu dhe Hysret Kyçyku, si pjesëtarë të grupit, dënohen nga gjykata ushtarake jugosllave në Sarajevë me nga 3 vite burg, pasiqë ata dënohen edhe për veprimtari brenda kazermës ushtarake.

Nexhat Ballazhi në burgun e Gjilanit qëndron 15 muaj ditë, ndërsa pjesën tjetër të burgut e mban në burgun e Dubravës. Në këtë burg, Nexhat Ballazhi njihet edhe me shokë të tjerë liridashës, duke marrë e dhënë eksperienca nga njëri tjetri.

Nga burgu i Dubravës lirohet më 21 shtator 1989, atëherë kur Kosova po vlonte nga protestat e demonstratat. Edhe pse u lirua nga burgu, aktivitetin ilegal e vazhdon përsëri. Bien në kontakt me organizatën dhe veprimtarinë e Lëvizjes, kështuqë më 26 janar 1990, Nexhat Ballazhi është njëri nga organizatorët e demonstratës së parë në Han të Elezit, ku brohoritej: Liri, Demokraci! Duam Punë! Kosovë po se po, Metohi jo se jo! Lironi shokët nga burgu e të ngjajshme. Kjo demonstratë ishte e fuqishme, por edhe dhuna nuk ishte e vogël. Arrestohen shumë demonstrues e në mesin e tyre, gjithsesi Nexhat Ballazhi. Në procedurë të shpejtë gjyqësore, Nexhat Ballazhi dënohet me 30 ditë burg, të cilin sërish e vuan në burgun e Dubravës, ku edhe ritakohet me shokët që pak muaj më parë ishte ndarë nga ata.
Nexhat Ballazhi, kujton:

Mbytja e Nuredin Nuredini nga Haraqina e Shkupit, në mbrojtje të pronës së vet, ishte ajo shkëndija kombëtare e cila vuri në lëvizje rininë dhe popullin shqiptarë. Një demonstratë e tillë u zhvillua edhe në Prishtinë me 24 janar 1990 në përkrahje të drejtave shqiptare në Maqedoni, por kjo shkëndi shumë shpejtë u përhap anë e kënd Kosovës me demonstrata të fuqishme. Vrasja e Nuredin Nuredini ishte vetëm shkasi, ndërsa shkaku ishte më i thellë; shtypja kombëtare e shqiptarëve kudo në ish Jugosllavi. Në këto rrethana të krijuara, nevoja për organizimin e një demonstrate u krijua edhe në Han të Elezit. Por, meqë në këtë trevë kurr s`kishte pasur më parë një demonstratë të tillë, edhe frika e njerzëve ishte evidente, pasiqë grupet ilegale që pushtuesi i zbuloi në vitin 1985 dhe 1987 i dënoi me dënime të rënda politike. Megjithate, vullneti i rinisë së Hanit të Elezit nuk kishte munguar kurrë, por mllefin e tyre ata e shprehnin në demonstratat që organizoheshin në Ferizaj e Prishtinë.

Andaj, pas këtyre rrethanave të krijuara, ne ish të burgosurit politik nga Hani i Elezit, që posa kishim dalur nga burgu, u organizuam në një takim të fshehtë dhe morëm vendim për organizimin e një demonstrate edhe në Han të Elezit. Në takim morëm pjesë : Ibrahim Curri, Mehmet Ballazhi dhe unë (Nexhat Ballazhi), të

gjithë të burgosur politik, që nuk kishim dy muaj që ishim liruar nga burgu dyvjeçar.
Takimi është mbajtur me 25 janar në shtëpinë e Mehmet Ballazhit, dhe aty është marrë vendimi për organizimin e demonstratës në Han të Elezit me 26 janar 1990 në ora 14.30. Në atë mbledhje, krahas caktimit të datës dhe orës së demonstratës, janë ndarë edhe detyrat e organizimit.
Ndarja e detyrave ka qene e shpejtë, pasi koha për organizimin e demonstratës ka qenë shumë e shkurtë. Andaj si pika e parë ka qenë ndarja e territorit në tri zona. Zona 1, 2 dhe zona 3.
Zona e parë ka qenë qendra e qytetit, e ndarë nga vija e lumit Lepenc, me vijën e magjistrales Prishtinë Shkup. Përgjegjësinë e organizimit për zonën e parë e ka pasur Mehmet Ballazhi.
Zona e dytë, e cila ka perfshi territorin mbi magjistralen Prishtinë - Shkup, nga ana e majtë, ka përshi Lagjen e Vileve, fshatin Paldenicë, Dërmjak, Dimcë. Përgjegjësinë e organizimit e ka pasur Ibrahim Curri.
Zona e tretë ka përfshi: Lagjen e Re, Seçishtën, Lagjen Brava, fshatin Guranë, fshatin Rezhancë dhe pergjegjësinë për organizim e kam pasur Unë, (Nexhat Ballazhi).

Baza kryesore e këtij organizimi kanë qenë familjet dhe familjarët tanë, shoqëria e ngushtë dhe miqësia e jonë. Në këtë takim është përcaktuar edhe programi i demonstratës; koha e nisjes së demonstratës, pika fillestare e nisjes së demonstratës, grumbullimi i demonstruesve në pika të caktuara, brohoritja e parullave, marshimi i protestuesve dhe kohëzgjatja deri te shpërndarja.

Koha e fillimit të demonstratës u caktua ora 14.30. Pika fillestare, ose nisja e demonstruesve ka qene prej stacionit të trenit. Pikat grumbulluese kanë qenë nëpër çajtoret e qytetit. Parullat kanë qenë; Liri - Barazi, Demokraci - Demokraci, Duam Punë, Poshtë dhuna shtetërore ndaj shqiptarëve, etj.

Marshimi është paraparë nëpër rrugët kryesore të qytezës, deri te dalja para portës së kombinatit të Fabrikës „Sharr" pasi ne, kishim planifikuar që në këtë kohë bëhej edhe lirimi i ndërrimit të parë të puntorëve të fabrikës dhe qëllimi ynë ishte që të masovizojmë demonstratën me bashkangjitjen edhe të klasës puntore. Përfundimin e sajë e kishim paraparë përsëri, te stacioni i trenit, pasi ne prisnim edhe intervenimin e policisë për shpërndarjen e demonstruesve, dhe kishim paraparë këtë pikë më të përshtatshme, për mbrojtje pasi kishim gurë me bollëk nga hekurudha, dhe hapsira për shpërndarje ishte e shumanëshme për

mos të rrezikuar arrestimin e demonstruesve nga policia.
Pas planifikimit, filloi zbatimi. Në zonën e tretë, unë pas konsulltimit me anëtarët e familjes, fillova organizimin. Për Lagjen e Bravëve caktuam, tani të ndjerin Musa Brava, për organizimin dhe informimin e lagjes, me mundesi që të informon edhe disa miq në fshatin Guranë. Për fshatin Seçishtë, kemi caktuar Ibush Shkretën, që të bëjë organizimin e rinisë së këtij fshati. Për Lagjen e Re kanë qenë të angazhuar Isak, Fahri dhe Rrahman Ballazhi. Me një fjalë, informimi dhe organizimi demonstratës ka shkuar në formë zingjirore me të afërm dhe shokë të ngushtë dhe miqësi dhe kjo u krye brenda natës.
Dhe erdhi dita e nisjes së demonstratës. Atë ditë Hani i Elezit gumëzhinte nga të rinjët e të gjitha fshatrave. Pak para nisjes, Unë edhe Ibrahimi vizituam, të gjitha çajtoret e qytezës për të parë gjendjen e protestuesve që pritnin kohën e nisjes. Gjendja ishte shumë optimiste dhe pjesëmarrja ishte shumë e kënaqëshme, mirëpo emocionet dhe përgjegjësia e organizimit ishte në kulmin e saj. Mllefi shumë vjeçar duhet të shpërthente. Gjithsesi duhej të shpërthente mllefi kundër pushtuesit serbosllav.
Dhe më në fund erdhi momenti i nisjes së demon-

stratës në ora fiks 14.30 te stacioni i trenit. Një grumbull prej rreth 30-40 vetave ishim mbledhur për të filluar demonstratën me 26 Janar 1990. Në fillim Ibrahim Curri, iu drejtua masës së tubuar me një fjalim atdhetar për të ngritur moralin e protestuesve. Pastaj Unë, kam lexuar parullat që do të brohoriteshin gjatë marshimit të demonstratës.

Dhe filluam marshimin. Ashtu në heshtje kemi marshuar deri te çajtorja e Milaim Bushit dhe prej aty kemi filluar brohoritjen e parullave. Menjëherë ka filluar bashkangjitja e protestuesve e cila për një kohë të shkurtër arriti numrin mbi 300-400 pjesëmarrës. Te ngjeshur krah për krah, marshuam nëpër rrugët kryesore të qytezës, duke brohoritur parullat: LiriBarazi, Demokraci-Demokraci, Duam Punë, Poshtë dhuna shtetërore!, etj.

Rreth orës 15. 00. U afruam te porta e fabrikës, dhe pritnim bashkangjitjen e punëtorëve. Mirëpo udhëheqësia e fabrikës, nuk lejonin që të hapej porta dhe puntorët të na bashkangjiten, andaj ne duke brohoritur parullën: Klasa punëtore është me ne! kemi hapur me dhunë portën e fabrikës dhe jemi futur në territorin e saj ku jemi bashkuar me puntorët, dhe kemi dalur prap jashtë. Na u bashkangjit vetëm një numër i caktuar i punëtorëve, u bashkangjit vetëm ajo shtresa me vetëdije të ngritur kombëtare, te pjesa tjetër

mbizotëroi frika e burgosjes, frika e largimit nga puna, frika...Pas gati dy orë të demonstrimit tonë, ashtu siç e kishim planifikuar, demonstruesit i koncentruam përsëri te stacioni i trenit, kur edhe arriti policia speciale për shpërndarjen e demonstratës.

Aty ishte edhe pjesa më e lavdishme e demonstratës, ku përleshja e demonstruesve përballë policisë speciale ishte në favorin tonë, pasi ne ishim të përgaditur për mbrojtje dhe me hedhjen e gurëve ndaj policisë i shpartalluam shumë keq ato. Mes gazit lotësjellës dhe perleshjes me gurë, zhvillohej beteja heroike kundër pushtuesit. Në këtë betejë po kalitej rinia jonë e cila më vonë do të jet edhe krahu i UÇK-së së lavdishme. Pastaj u mor vendimi që demonstrata të shpërndahej dhe të vazhdohej prap ditëve të tjera. Demonstrata përfundoj ashtu edhe siç ishte planifikuar nga organizatorët, duke i përmbushur të gjitha pikat që ishin paraparë. Vlen të përmendet se demonstruesit kanë qenë shumë të disiplinuar dhe nuk kanë shkaktuar as edhe një dëm të pronës private apo shoqërore.

Menjëher pas shpërndarjes së demonstratës, organet e pushtetit filluan ndjekjet e organizatorëve, për arrestimin e tyre. Kështu të nesërmen vonë pasdite, unë u arrestova së bashku me Mehmetin dhe me procedurë të shpejt u denuam me nga 30 ditë burg, nga

gjykata për kundërvajtje në Kaçanik. Së bashku me ne është dënuar edhe profesori Emrush Dernjani dhe shumë demonstrues të tjerë.
Vlen të theksohet se demonstratat kanë vazhduar edhe pas arrestimit tonë edhe për një javë, derisa më në fund janë përdorur edhe armët e zjarrit ndaj protestuesve, por për fat të mirë pa pasoja fatale në njerëz, kujton ish i burgosuri politik Nexhat Ballazhi.
Nexhat Ballazhi pas kthimit nga burgu, regjistrohet në Fakultetin e Historisë në Prishtinë, por i ballafaquar me rrethanat e rënda të arsimit që ishin në atë kohë, nuk mundi ta vazhdoj më tej. Viti 1990, shënon shumë ngjarje. Sistemi shumë partiak tanimë ishte lejuar, por Kosova ishte nën kthetrat e Serbisë okupatore, andaj krahas aktivitetit në subjektin legal të Forumit Rinor të LDK-së, Nexhat Ballazhi, bashkë me shokët e tjerë të ilegales, angazhohet ilegalisht në mbledhjen e mjeteve materiale për blerjen e armëve që në vitin 1991. Veprimtaria e Nexhat Ballazhit shtrihet edhe në grupin e të rinjëve të Grupit letrar „Luigj Gurakuqi" i cili grup përveç që ishte letrar, ishte edhe mobilizues e çlirimtare. Rrethanat e veprimit ishin të rënda, ndërsa situata e gjithmbarshme gjithnjë e ma e vështirë. Dhuna, ndjekjet, bastisjet dhe kërkimi i armëve në Han të Elezit, bënë që Nexhat Ballazhi në pjesën e dytë të vitit 1995, ilegalisht të kalon kufirin e Bllacës dhe kalon

në Shkup. Nga Shkupi kalon në Tiranë e nga Tirana në Zvicërr ku edhe e vazhdon aktivitetin e tij pranë Lëvizjes Popullore të Kosovës. Merr pjesë aktive në demonstratat që zhvilloheshin në shtetet perëndimore kundër shtypjes serbe mbi Kosovë, ndërsa në vitin 1998 angazhohet në Fondin „Vendlindja Thërret" duke dhënë një angazhim maksimal në luftën për liri.
Nexhat Ballazhi dhe familja e gjërë e tij ishin në krah të lirisë dhe si të tillë shumë anëtarë nga kjo familje ishin pjestarë të UÇK-së e në mesin e tyre edhe vëllezërit e tij, ku Samet Ballazhi zihet rob lufte në betejën e Pashtrikut të 14 dhjetorit 1998, ndërsa djali i axhës së tij, Veli Ballazhi bie dëshmor bashkë me Mujë
Krasniqin e luftëtarë të tjerë. Samet Ballazhi, pas 40 dite qëndrimi në burgun e Nishit, shkëmbehet me ushtarët serb të zënë robë nga UÇK-ja, ngjarje kjo gjithsesi me rëndësi të veçant.
Pas përfundimit të luftës, Nexhat Ballazhi, aktivitetin e tij e zhvillon në rrethana të tjera, tanimë në ndihmë Shoqatës për invalidët e luftës së UÇK-së dhe Miqëve të TMK-së.
Nexhat Ballazhi sot, bashkë me familjen e tij të ngushtë, jeton si mërgimtar në Zvicërr gjithmonë me sytë e kthyer nga atdheu, nga Kosova dhe liria e saj.

Ekrem Ahmet Rogaqi është i lindur më 26.10. 1958 në Shkup. Jeton në Han të Elezit. Ka të kryer shkollën fillore. Me datë 23 dhe 24 tetor 1987 në bashkëveprim me Selajdin Sumën, në një bllok vizatimi nr.5, e kanë shkruar parullën Kosova - Republikë dhe të njejtën e kanë vendosur në dritaren e shitores „Çair". Në aktakuzë thuhet se janë marrë vesh që të shkruajnë edhe parulla të tjera, madje, si: Rroftë Sali Bajra, Bedri Kyçyku dhe PK e Shqipërisë! Për këtë vepër (nacionaliste, irredentiste e antishtetërore siç e quante pushteti jugosllav) Ekrem Rogaqi dënohet me 60 ditë burg të cilin e vuan në burgun e Gjilanit. Në vitet e 90-ta, Ekrem Rogaqi, si ushtar me pagesë, për dy vite me radhë ka shërbyer edhe në ushtrinë kroate, kundër asaj serbe. Ka shërbyer në Brigadën kundërdiverzante. Krahas këtij aktiviteti, gjatë luftës së Kosovës, Ekrem Rogaqi ka qenë pjesëtar i Brigadës 138 Agim Ramadani të UÇK-së në Koshare. Është veteran i UÇK-së. Është i martuar, baba i katër fëmijëve. Jeton në Han të Elezit.

Selajdin Suma

(1967- 1989)

Selajdin Suma është i lindur më 22.5. 1967 në fshatin Dimcë të Hanit të Elezit. Ka të kryer shkollën e mesme dhe ishte i pamartuar. Me datë 23 dhe 24 tetor 1987 në bashkëveprim me Ekrem Ahmet Rogaqin, në një bllok vizatimi nr.V, e kanë shkruar parullën Kosova - Republikë dhe të njejtën e kanë vendosur në dritaren e shitores ,,Çair''. Në aktakuzë thuhet se janë marrë vesh që të shkruajnë edhe parulla të tjera, madje, si: Rroftë Sali Bajra, Bedri Kyçyku dhe PK e Shqipërisë!

Për këtë vepër, Selajdin Suma zbulohet dhe dënohet me 60 ditë burg të cilin edhe e vuan në burgun e Gjilanit, dhe jo vetëm kaq. Gjatë hetimeve dhe pas vuajtjes së dënimit pjesëtarët e UDB-së në Kaçanik, vazhdimisht e kanë mbajtur në presion dhe shantazh psikologjik Selajdin Sumën, kështuqë me datën 26.9.1989, Selajdin Suma bëri vetëvrasje nën rrotat e trenit në Han të Elezit. Ka dëshmitarë okular të cilët kanë dëshmuar se një ditë para se të bëj vetëvrasje Selajdini, atë e kanë parë në zyren e UDB-së në Kaçanik, krejtësisht të gjakosur nga torturat.

Fahri Bushi është i lindur më 2.7.1964 në Han të Elezit. Është një kuadër me vlerë në komunën e Hanit të Elezit. Ka të kryer Fakultetin e Gjuhës shqipe dhe atë Ekonomik. Për shumë vite ka punuar si profesor pranë shkollës së mesme „Dardania" në Han të Elezit. Krahas kësaj pune, Fahri Bushi doktoron edhe në shkencat ekonomike ku
edhe punon në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Kur në vitin 1991 u formua Grupi letrar „Luigj Gurakuqi" në Han të Elezit, Fahri Bushi ishte aktiv me shkrimet e tij.

Kur në vitin 1989, politika fashizoide e Milloshevìqit suprimoi autonominë e Kosovës, revoltat dhe demonstratat shpërthyen në të gjitha anët. Një e tillë, shpërthen edhe në Qendrën e Studentëve në Prishtinë më 31 maj 1989. Fahri Bushi si student ishte pjesëmarrës i kësaj proteste dhe në të njejtën ditë, arrestohet dhe dënohet me 60 ditë burg të cilin edhe e vuan në burgun e Dubravës në Istog.



Emrush Dernjani është i lindur më 20.11.1952 në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Rrjedh nga një familje me tradita atdhetare dhe arsimdashëse. Pas kryerjes së shkollës fillore në Han të Elezit, regjistrohet në Shkollën Normale në Prishtinë të cilën e kryen me sukses në vitin 1972. Në vitin 1973 punësohet në fshatin e tij në Paldenicë dhe është mësuesi i parë nga fshati. Emrush Dernjani ishte i pasionuar ndaj leximit e studimit, kështuqë kreu edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike, dega histori/gjeografi në Shkup, në vitin 1976, ndërsa Fakultetin e Historisë e kreu në vitin 1985. Ndërkohë i vazhdon edhe studimet e magjistraturës. Ka punuar si profesor i historisë në shkollë fillore dhe ate të mesme në Han të Elezit. Për disa vite me radhë ishte edhe drejtor i insitucionit shkollor në Han të Elezit dhe në fshatin Paldenicë. Emrush Dernjani, si profesor i historisë, i njihte mirë të gjitha padrejtësitë historike që iu bënë popullit shqiptarë, andaj ishte në krah të çdo lëvizje progresiste. Kur në Han të Elezit shpërtheu demonstrata e parë, ai la ditarin dhe iu bashkangjitë demonstratës për Liri e Demokraci, për të Drejta e Barazi. Si pjesëmarrës i demonstratës së 26 janarit 1990 në Han të Elezit

arrestohet dhe dënohet me 30 ditë burgim të cilin e vuan në burgun e Dubravës. Prof. Emrush Dernjani ishte aktiv në jetën politike dhe ka bashkëpunuar me aktivist të dalluar kombëtar,si Sali Bajrën, Bedri Kyçykun, Gafurr Lokun, Hebib Shehun dhe ishte aktiv në pajtimin e gjaqeve e të ngatërresave brendashqiptare. Prof. Emrush Dernjani ishte një kontributdhënës i madh në edukim dhe nxori shumë gjenerata, nxori shumë kuadro të cilët edhe sot i shërbejnë atdheut. Si atëdhedashës ishte motivues i luftës për liri dhe dy djemt e tij ishin pjesëtarë të UÇK-së. Për herë të dytë, arrestohet nga forcat policore serbe edhe me 16 mars 1999 dhe torturohet në stacionin policor të Ferizajt ku edhe më pas lirohet. Aktualisht është në pension. Ka botuar tri libra me rëndësi historike për trevën e Hanit të Elezit.

Fatmir Meliqi (1964-2019)

Fatmir Meliqi është i lindur më 10.7.1964 në fshatin Rezhancë (Lagja Meliq) të Hanit të Elezit. Ka të kryer shkollën e mesme. Më shpërthimin e demonstratave më 26 janar 1990 në Han të Elezit, bashkë me shokë të tjerë, mori pjesë në këtë demonstratë ku krahas parullës për Liri e Demokraci, Duam punë, Duam Bukë, brohoritej edhe parulla Kosovë po se po, Metohi jo se jo! Fatmir Meliqi arrestohet me datën 29.1.1990 dhe dënohet me 60 ditë burg të ciln e vuan në Dubravë të Istogut. Fatmir Meliqi një kohë të gjatë ka punuar në Itali dhe ka pasur problem me shëndetin, duke qëndruar në dializë. Vdes në Itali më 1.10.2019, ndërsa në Kosovë varroset më 18.10.2019 duke lënë si pasardhës dy fëmijë.

Fehmi Braka (1970-2009)

Fehmi Braka është i lindur më 23 mars 1970 në Han të Elezit. Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmen në Kaçanik.

Nën pushtimin serb, shtypja dhe padrejtësia e kishin mbuluar Kosovën, por edhe rezistenca shqiptare ishte e fuqishme. Rinia shqiptare ishte në ballë të kësaj rezistence dhe pavarësisht dhunës dhe terrorit që zbatonte pushtuesi, protestat dhe demonstratat nuk pranin. Një demonstratë e tillë u organizua edhe në Han të Elezit më 26 janar 1990. Në këtë demonstratë e cila jo vetëm që ishte e para, por ishte edhe vrullshme, ishte dinamike dhe përballej me policinë fuqishëm. Hani i Elezit buçiste për të drejta e barazi, për liri e demokraci. Njëri nga ata që mori pjesë në këtë demonstratë ishte edhe Fehmi Braka i cili edhe arrestohet nga policia. Fehmi Braka dënohet me 30 ditë burg dhe dënimin e vuan në burgun e Dubravës. Valët e jetës, në janarin e vitit 1991 Fehmiun e dërguan në Gjermani ku edhe punon si mërgimtar dhe mbante familjen e tij. Më 28 dhjetor 1992 martohet, ndërsa me 3 janar 1993, nga bastisjet e shumta që bëheshin, madje edhe shtëpia e tij, në mënyrë ilegale kalon kufirin dhe sërish shkon në Gjermani. Më vonë në mërgim i kalon edhe bashkëshortja e tij. Në Gjermani Fehmiu, sëmuret dhe në moshën 39 vjeçare vdes në Duisburg të

Gjermanisë më 6 mars 2009. Vdes nga sëmundja e kancerit. Varroset te varrezat e Hanit të Elezit në Rrafshe. Ishte i martuar dhe babai i katër fëmijëve.

Femi Meliqi është i lindur më 24.7.1966 në fshatin Rezhancë (Lagja Meliq) të Hanit të Elezit. Ka të kryer shkollën fillore. Më shpërthimin e demonstratave më 26 janar 1990 në Han të Elezit, bashkë me shokë të tjerë, mori pjesë në këtë demonstratë ku krahas parullës për Liri e Demokraci, Duam punë, Duam Bukë, brohoritej edhe parulla Kosovë po se po, Metohi jo se jo! Femi Meliqi arrestohet me datën 7 shkurt 1990 dhe dënohet me 40 ditë burg të ciln e vuan në Dubravë të Istogut.



Ibrahim Vila është i lindur më 26.11.1965 në Han të Elezit. Ka të kryer shkollën e mesme dhe është baba i katër fëmijëve. Mori pjesë në demonstratën e 26 janarit 1990 në Han të Elezit, ku brohoritej për Liri e Demokraci, kërkesa këto që për regjimin jugosllav që po jepte shpirt, klasifikoheshin si armiqësore dhe që ndëshkoheshin me ligjet në fuqi. Ibrahim Vila ishte mjaft aktiv gjatë demonstratës e cila zgjati disa ditë dhe vetëm me intervenimin e policisë special, shuhet. Gjatë këtyre demonstratave Ibrahim Vila arrestohet nga policia dhe dënohet me 40 ditë burg. Dënimin e mban në burgun e Dubravës. Jeton në Han të Elezit.

Menduh Brava është i lindur më 6.6.1965 në Puset e Nikës të Hanit të Elezit. Ka të kryer shkollimin e mesëm. Rrjedh nga një familje me tradita kombëtare, ku gjyshi i tij Nazmi Brava ka mbajtur burg të rëndë që nga viti 1948. Menduh Brava, mori pjesë në demonstratën e parë të 26 janarit 1990 që u organizua në Han të Elezit. Jo vetëm që ishte demonstrata e parë, por ishte një demonstratë që ngriti edhe më shumë vetëdijën kombëtare për liri. Menduh Brava ishte tejet aktiv në këtë demonstratë, andaj edhe arrestohet dhe dënohet me 60 ditë burg të cilin edhe e vuan në Prishtinë, Dubravë dhe Smrekovnicë. Arrestohet me 28 janar 1990 dhe akuzohej se : Ka marrë pjesë në demonstratën e organizuar dhe kanë hyrë në oborr të fabrikës duke brohoritur parullat: Demokraci, Duam Bukë, Duam punë! Menduh Brava gjatë luftës çlirimtare të Kosovës ishte pjesëtar i Brigadës 164 „Gafurr Loku" të UÇK-së në Han të Elezit duke dhënë një kontribut të madh për liri. Është veteran i UÇK-së, aktualisht kryetar i Degës së OVL-UÇK-së në Han të Elezit.

është i lindur më

Minah Shkreta

18.1.1971 në fshatin Seçishtë të Hanit të Elezit. Ka të kryer shkollën fillore. I motivuar nga situata e përgjithshme që mbretëronte në Kosovë, bashkë me shumë shokë të tjerë, mori pjesë në demonstratën e parë të 26 janarit 1990 në Han të Elezit. Meqenëse demonstrata ka zgjat-
ur disa ditë, Minah Shkreta arrestohet më 23 shkurt 1990 dhe nga Gjykata për kundërvajtje në Kaçanik dënohet me 60 ditë burg. Burgun e vuan në Dubravë të Istogut dhe atë të Smrekonicës, ku edhe lirohet me kusht me datë 16.4.1990. Është babai i katër fëmijëve. Jeton në fshatin e lindjes.



Murat Loku është i lindur më 17.5.1958 në fshatin Kotlinë të Kaçanikut. Pas shpënguljes nga ky fshati, vendoset në Lagjen e Ujit të Thartë të Hanit të Elezit. Ka të kryer shkollimin e mesëm në Kaçanik dhe është punëtor pranë Fabrikës së çimentos. Murat Loku rrjedh nga një familje me tradita

kombëtare. Është pjesëmarrës i demonstratës së 26 janarit 1990. Si pjesëmarrës aktiv i kësaj demonstrate, përkundër pengesave nga personeli i fabrikës, që punëtorët mos t`i bashkangjiten demonstratës, ai hapi me forcë portën e fabrikës ku siç thoshte A. Jackon *se një njeri i guximshëm bën shumicën*, Murat Loku ishte personazhi më tipik i kësaj situate. Natyrisht se e arrestojnë Murat Lokun dhe në procedurë të shpejtë gjyqësore e dënojnë me 40 ditë burg. Atë e vuan në Dubravë dhe Smrekovnicë duke u kalitur edhe më shumë në betejat e lirisë. Përkundër kësaj, në familjen Loku, çështja shqiptare ishte kryetema në oda. Kishte shumë shokë e miq. Murat Loku, përshkak se çdo herë në kokë e barte plisin e bardhë, në majin e vitit 1998, torturohet rëndë, tepër rëndë nga policia serbe. Kur në Han të Elezit më 26 shkurt 1999, shpërtheu lufta, Murat Loku ishte pjesë e kësaj lufte çlirimtare. Kishte kohë që e kishte pritur një ditë të tillë. Në ballafaqim me forcat serbe, të cilat synonin të pushtonin zonën e lirë të luftës në Puset e Nikës, Murat Loku plagoset rëndë dhe ashtu me plagë të rënda, ku pothuajse tërë zorrët e barkut i kishin dalur jashtë, ai e vazhdoi luftën. Është veteran dhe invalid i UÇK-së. Familja e tij ka dhënë luftëtarë dhe dëshmorë të lirisë. Është babai i gjashtë fëmijëve.

është i lindur më



Rabit Kurti

22.9.1964 në fshatin Paldenicë të Hanit të Elezit. Viteve të shtatëdhjeta familja e tij u shpërngul në Han të Elezit ku Rabiti edhe e kryen shkollimin fillor e më pas edhe atë të mesëm. Ngjarjet që zhvilloheshin në Kosovë, s`kishin se si mos të ndikonin edhe në shpirtin e njomë të tij. Në rrjedhë të këtyre ngjarjeve, një demonstratë e tillë u organizua edhe në Han të Elezit. Rabit Kurti është pjesëmarrës i demonstratës së 26 janarit 1990, ku brohoritej për Liri e Demokraci, për Bukë e Punë dhe ajo Kosovë po se po, Metohi jo se jo! Rabit Kurti për pjesëmarrje në këtë demonstratë arrestohet dhe dënohet me 50 ditë burgim. Burgun e vuan në Dubravë të Istogut. Pas viteve të 90 –ta kalon në Perëndim ku është edhe sot.

Zekirija Shkreta është i lindur më 26.4.1971 në fshatin Seçishtë të Hanit të Elezit. Pas kryerjes së shkollës fillore, të mesmen e kryen në Kaçanik. Mori pjesë aktive në demonstratën e zhvilluar të 26 janarit të vitit 1990 në Han të Elezit

e cila shpërtheu vrullin rinorë të akumuluar me vite. Kjo demonstratë zgjati rreth një javë, duke brohoritur Liri, Demokraci, Barazi, Kosovë po se po, Metohi jo se jo, Duam Punë e të ngjajshme. Për të shuar këtë demonstratë, intervenon edhe policia speciale, ku krahas gazit lotësjellës gjuajnë edhe në objekte private dhe shoqërore. Për pjesëmarrje në demonstratë arrestohet dhe dënohet me 60 ditë burg të cilin edhe e vuan në Dubravë dhe Smrekovnicë. Karakteristikë tjetër e kësaj demonstrate ishte se ajo arriti ta shpërthej frikën e mbjellur thellë ndër masat popullore dhe në rrjedhë të kohës shumë pjesëmarrës të kësaj demonstrate iu bashkangjitën radhëve të UÇK-së. Njëri nga ata ishte edhe Zekirija Shkreta. Ai në pranverën e vitit 1998, bënë pjesë në grupin e vetorganizuar të UÇK-së për bartjen e armëve. Pas zbulimit të grupit dhe bastisjeve nëpër shtëpia, Zekirija Shkreta arrinë t`i ikë arrestimit dhe del në Puset e Nikës, ndërsa familja detyrohet të shpërngulen në Shkup. Bën pjesë në njësitin e parë të UÇK-së në Puset e Nikës e rrjedhimisht edhe të Brigadës 164 të UÇK-së. Gjatë luftës çlirimtare dha një kontribut të madh. Pas luftës ishte pjesë e TMK-së, më sakt në Batalionin e Xhenios në Han të Elezit. Kanë deminuar shumë zona lufte që armiku i kishte minuar. Pas transformimit të TMK së, Zekirija Shkreta bëhet pjesë

është i lindur më e FSK dhe aktualisht ka gradën e Majorit. Në vitin 1998, nga gjykata pushtuese serbe është i dënuar në mungesë me 5 vite burg. Gjatë karrierës së tij ushtarake, arrin të kryej edhe Fakultetin e Emergjencave. Jeton në fshatin Seçishtë të Hanit të Elezit.

Sherif Berisha

16.4.1969 në fshatin Gorancë, ku më pas shpërngulet në Han të Elezit. Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmen në gjimnazin e Kaçanikut. Dalja në skenë e UÇK-së më 28 nëntor 1997 dhe sulmi i forcave policore-ushtarake serbe mbi familjen Jashari në Prekaz, ngriti në këmbë tërë kombin shqiptarë. Një shkëndijë e luftës për liri, tanimë me flamur të UÇK-së, shkrepi edhe në Han të Elezit. Kështuqë në prill të vitit 1998, njëri nga ata që vetorganizohen bashkë me shokët e tjerë për të ngritur një celulë të UÇK-së është edhe Sherif Berisha. Në këtë grup kishte edhe disa shokë të tjerë, dhe arrijnë që disa armë nga Tetova t`i fusin në Han të Elezit. Tentuan që armë të fusin edhe nga vija tjetër e Shkupit, por zbulohen nga policia dhe ushtria serbe me 16 qershor 1998, dhe në mesin e të arrestuarve ishte edhe Sherif Berisha. Bashkë me të arrestuarit e tjerë, fillimisht e

mbajnë në stacionin policor në Han të Elezit, pastaj në Kaçanik dhe sidomos në Ferizaj ku edhe torturohet rëndë. Nga Ferizaj dërgohet në Burgun e Gjilanit, bashkë me Valon Berishën e Shefket Topojanin, ndërsa Arif Curri arrin të ikë nga stacioni policor i Ferizajt. Pas tre muajëve i nxjerrin në gjyq të Prishtinës ku Sherif Berisha dënohet me 6 vite burg, ndërsa shokët që mbetën pa u arrestuar si Rufki Suma, Rexhep Shkreta, Zekirija Shkreta e Nesim Curri kalojnë në arrati në Puset e Nikës dhe formojnë Njësitin e UÇK-së.

Pas shqiptimit të dënimit nga gjykata e instaluar serbe në Prishtinë, Sherif Berisha bashkë me Shefket Topojanin e Valon Berishën, transferohet në burgun e Lypjanit e nga Lypjani në Mitrovicën e Sremit, ku krahas qëndrimit me të burgosurit e tjerë, qëndron edhe me Ukshin Hotin, i cili nga 16 maji i vitit 1999 nuk dihet fati i tij. Meqë lufta dhe bombardimet e NATO-s po zhvilloheshin me intenzitet të madh, të burgosurit nga Mitrovica e Sremit, nëpërmjet Nishit i transferojnë në burgun e Dubravës, ku shteti serb tanimë kishte bërë skenarin e masakrës. Sherif Berisha është përjetues i masakrës serbe ndaj të burgosurve shqiptarë në Dubravë nga 19 - 24 maj 1999. Me 24 maj 1999 e transferojnë sërish në burgun e Lypjanit dhe me 10 qershor 1999 si peng lufte, transferohet në burgun e Nishit bashkë me shokë të tjerë, ku krahas dhunës së

është i lindur më shfrenuar serbe, uria ishte edhe një torturë tjetër. Në burgun e Nishit, kushtet ndaj të burgosurve kanë qenë mizerje, kështuqë Sherifi, shokëve u ka ndihmuar edhe me qethjen e flokëve, duke luajtur edhe rolin e berberit. Sherif Berisha është edhe përjetues i kalljes së burgjeve nga të burgosurit serb në Serbi dhe pas shumë vuajtjeve e torturave, lirohet nga burgu i Nishit më 7 prill të vitit 2001, bashkë me Valon Berishën e Shefket Topojanin, duke mbajtur 2 vite e 11 muaj burg. Nga nëntori i vitit 2021 është zgjedhur asambleist i

Kuvendit komunal të Hanit të Elezit. Jeton në Han të Elezit.

Valon Berisha është i lindur më 21.7.1971 në fshatin Gorancë. Në vitin 1976 shpërngulen në Han të Elezit, ku Valoni kreu shkollën fillore, ndërsa të mesmen në gjimnazin e Kaçanikut.

Epopeja e Prekazit e 5, 6 e 7 marsit të vitit 1998 ngriti në këmbë tërë kombin shqiptarë. Një shkëndijë e luftës për liri, tanimë me flamur të UÇK-së, shkrepi edhe në Han të Elezit. Kështuqë në prill të vitit 1998, njëri nga ata që vetorganizohen për të ngritur një celulë të UÇK-së është edhe Valon Berisha. Në këtë grup kishte edhe disa shokë të tjerë, si: Rufki Suma, Nesim Curri, Arif Curri, Sherif Berisha, Zekirija Shkreta, Rexhep Shkreta, Shefket Topojani, Hamit Berisha, Fadil Berisha e Afet Kryeziu dhe arrijnë që disa armë nga Tetova t`i fusin në Han të Elezit. Tentuan që armë të fusin edhe nga vija tjetër e Shkupit, por zbulohen nga policia dhe ushtria serbe më 16 qershor 1998, dhe në mesin e të arrestuarve ishte edhe Valon Berisha. Pas arrestimit, dërgohen në stacionin policor të Hanit të Elezit, pastaj në Kaçanik e Ferizaj ku edhe torturohen rëndë. Nga

Ferizaj i dërgojnë në burgun e Gjilanit e më pas i nxjerrin në gjyqin pushtues serb në Prishtinë, ku Valon Berisha dënohet me 5 vite burg. Ndërkohë, derisa një pjesë e celulës bie në burg, ndërsa pjesa tjetër arratisen në mal, në shtëpitë e tyre bëhen bastisje e reprezalje të mëdha, ku familjet detyrohen të ikin në Shkup.

Nga Prishtina transferohet në burgun e Lypjanit e nga Lypjani në burgun e Mitrovicës së Sremit ku njifet edhe me shumë shokë të tjerë bashkëvuajtës, si me Nait Hasanin, Enver Dugollin, Bajrush Xhemajlin, Ukshin Hotin, Bislim Zogajn... dhe meqë lufta dhe bombardimet e NATO-s po zhvilloheshin me intenzitet të madh, të burgosurit nga Mitrovica e Sremit, nëpërmjet Nishit i transferojnë në burgun e Dubravës, ku shteti serb tanimë kishte bërë skenarin e masakrës. Janë të rënda përjetimet e të burgosurve nga një burg në tjetrin, ku torturat ndaj tyre ishin të rënda. Në burgun e Dubravës Valon Berisha, takohet edhe me shokë të tjerë nga Hani i Elezit, si: Shaban Çupin, Shefket Beqën, Sabedin Hasallarin e Suad Bravën dhe me shokët e Kaçanikut si: Gafurr Lumën, Mejdi Dalloshin, Tefik

Rakën, Danush Kurtajn, Hasan Dalloshin, Fatmir Kurtajn e shumë të tjerë. Valon Berisha është edhe përjetues i masakrës serbe ndaj të burgosurve shqiptarë në Dubravë nga 19 - 24 maj 1999. Me 24 maj

1999 e transferojnë në burgun e Lypjanit dhe me 10 qershor 1999 si peng lufte, transferohet në burgun e Nishit bashkë me shokë të tjerë, ku krahas dhunës së shfrenuar serbe, uria ishte edhe një torturë tjetër e përditëshme. Valon Berisha është edhe përjetues i kalljes së burgjeve nga të burgosurit serb në Serbi dhe pas shumë peripecive lirohet nga burgu i Nishit më 7 prill të vitit 2001, duke i mbajtur 2 vite e 11 muaj. Jeton në Han të Elezit. Nga dhjetori i vitit 2021 është kryetar i Shoqatës së të Burgosurve Politik të Hanit të Elezit.

Shefket Topojani është i lindur më 2.6.1969 në Han të Elezit. Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmen në Kaçaniku dhe në Ferizaj.

Zjarret e marsit në Prekaz të 5, 6 e 7 marsit të vitit 1998 ngriti në këmbë tërë kombin shqiptarë.

Krahas protestave e demonstratave gjithandej botës shqiptare, tani një forcë ushtarake kishte lëshuar kushtrimin. Ishte flaka e UÇK-së e cila po shtrihej kudo. Një flakë e tillë u përhap edhe në Han të Elezit. Kështuqë në prill të vitit 1998, njëri nga ata që vetorganizohen për të ngritur një celulë të UÇK-së është edhe Shefket Topojani. Në këtë grup kishte edhe

disa shokë të tjerë, dhe arrijnë që disa armë nga Tetova t`i fusin në Han të Elezit. Tentuan që armë të fusin edhe nga vija tjetër e Shkupit, por zbulohen nga policia dhe ushtria serbe me 16 qershor 1998, dhe në mesin e të arrestuarve ishte edhe Shefket Topojani. Fillimisht dërgohen në stacionin policor të Hanit të Elezit, pastaj të Kaçanikut dhe Ferizajt. Nga Ferizaj, transferohen në burgun e Gjilanit, ku krahas torturave për veprën që ngarkoheshin, torturohen edhe për zbulimin e veprimtarisë së Gafurr Lokut e Shaban Çupit. Pas disa muaj hetime i nxjerrin në gjyq të Prishtinës ku Shefket Topojani në shtatorin e vitit 1998, dënohet me 5 vite burg. Shefket Topojani bashkë me shokët e tij, nga Prishtina transferohet në burgun e Lypjanit e nga Lypjani në burgun e Mitrovicës së Sremit në Vojvodinë, ku krahas qëndrimit me të burgosurit e tjerë, si: Bajrush Xhemaili, Avni Klinaku, Liburn Aliu, Dilber Beka, Nait Hasani, Besim Rama, Bislim Zogaj,... qëndron edhe me Ukshin Hotin, nga i cili edhe sot ruan kujtime nga më të ndryshmet.

Bombardimet e NATO-s të 24 marsi 1999 ndaj Serbisë, Shefket Topojanin e gjejnë në burgun e Mitrovicës së Sremit në Vojvodinë. Në rrethana lufte, të burgosurit nga Mitrovica e Sremit, nëpërmjet Nishit i transferojnë në burgun e Dubravës, ku shteti serb tanimë kishte bërë skenarin e masakrës. I tëri ky udhëtim nga një

burg në tjetrin, bëhej nën tortura të rënda, ku shovenizmi serb zbrazej mbi trupin e të burgosurve shqiptarë. Shefket Topojani është edhe përjetues i masakrës serbe ndaj të burgosurve shqiptarë në Dubravë nga 19-24 maj 1999. Në burgun e Dubravës, një copë metalike e shpërthyer nga raketa më 21 maj 1999, goditi krahun e djathtë të Shefketit, por fati i tij ishte se copa e saj e goditi me sipërfaqe duke i krijuar vetëm lëndime e jo prerje. Me 24 maj 1999 e transferojnë në burgun e Lypjanit dhe me 10 qershor 1999 si peng lufte, transferohet në burgun e Nishit bashkë me shokë të tjerë, ku krahas dhunë së shfrenuar serbe, uria ishte edhe një torturë tjetër. Shefket Topojani është edhe përjetues i kalljes së burgjeve nga të burgosurit serb në Serbi dhe pas shumë vuajtjeve lirohet nga burgu i Nishit më 7 prill të vitit 2001, duke qëndruar në burg 2 vite e 11 muaj. Është i martur dhe babai i tre fëmijëve. Jeton në Han të Elezit.

Suad Brava (1982-1999)

Suad Brava është i lindur më 11 mars 1982 në Puset e Nikës të Hanit të Elezit. Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit dhe regjistrohet në shkollën e mesme „Dardania''. Me formimin e Njësitit të UÇK-së në Puset e Nikës, bëhet pjesë e luftës çlirimtare. Si i ri, fillimisht bën roje pranë Njësisë luftarake, dhe në këtë gjendje, më 26 shkurt 1999 shpërthejnë edhe pushkët e para çlirimtare në Puset e Nikës. Pos 26 shkurtit, Suad Brava përjeton edhe ofenzivën armike të datës 2 mars 1999, ku edhe arrestohet nga forcat policoro-ushtarake serbe. Arrestohet në afërsi të Rekës së Kotlinës. Nga torturat për disa ditë qëndron edhe në spitalin e Prishtinës, ku avokat kishte Bajram Kelmendin i cili edhe ai më vonë vritet nga pushtuesi serb bashkë me të bijtë e tij. Meqenëse ishin rrethana lufte dhe familja

e Suadit shpërngulen me dhunë për në Shkup, avokati Bajram Kelmendi përkujdeset që t`i dërgoj rrobat e djalit të tij Kushtrimit në burgun e Prishtinës. Meqë me 28 mars 1999 nga një raketë e NATO-s sulmohet objekti policor i Prishtinës e bashkë me atë edhe burgu, Suadin bashkë me shokë të tjerë e transferojnë në burgun e Lypjanit ku krahas torturave, e rëndë ka qenë edhe uria. Më 30 prill 1999 nga burgu i Lypjanit transferohet në burgun e Dubravës dhe ka qëndruar në pavijonin „B ʺ në katin e dytë majtas. Kur më 19 maj 1999 nga raketat e NATO-s sulmohet burgu, të burgosurit thyejnë dyert, dhe dalin në oborr të burgut, në mesin e tyre ishte edhe Suad Brava.
Të burgosurit, ftohen nga gardianët që të rreshtohen në Fushën Sportive të burgut. Ishin rreth 960 të burgosur. Në mesin e tyre edhe Suad Brava. Në momentin e rreshtimit, nga karakollat e burgut me të gjitha llojet e armëve gjuhen të burgosurit, ku edhe vriten 117 të burgosur e mbi 200 mbetën të plagosur. Në këto rrebeshe sulmi, goditet edhe Suad Brava. Plumbi e mori në veshkë dhe i depërtoi tej më tej trupit. Ashtu të plagosur, gjatë tërë ditës e kanë tërhequr shokët e burgosur nga Hani i Elezit,si: Sabedin Hasallari, Shefket Topojani, Sherif Berisha, Shaban Çupi, Valon Berisha, Isa Bushi, Shefket Beqa, Qamil Abazi. Më vonë detyrohen të barikadohen edhe në menzën e

burgut ku Suadin e plagosur rëndë e shtrijnë mbi disa thasë të pateteve, pasiqë bodrumi kishte ujë. Në pamundësi për t`i dhënë ndihmë tjetër, në orët e hershme të mëngjesit të datës 23 maj 1999, ndërroi jetë edhe i mituri Suad Brava, ku pushtuesi serb me vrasjen e tij, shkeli të gjitha konventat ndërkombëtare, pasiqë Suadi ishte i burgosur nën akuzë dhe u ekzekutua pa gjyq. Suad Brava jetoi 17 vite e tre muaj. Ishte pjesëtar i UÇK-së pranë Brigadës 164 ,,Gafurr Loku'' të UÇK-së në Han të Elezit. Trupi i pajetë i tij gjendet pas lufte në varrezat masive të Rakoshit. Varroset me nderime ushtarake në varrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës. Me vendim Presidencial është shpallur Hero i Kosovës. Krahas rrugëve, stadioni i futbollit në Han të Elezit bart emrin e tij.

Sabedin Hasallari është i lindur më 19 qershor 1970 në fshatin Rezhancë. Pasi shpërngulet me familje në Lagje të Re, shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmen në Kaçanik si teknik laborant i kimisë.

Kur më 14 dhjetor 1998, në

Pashtrik bie dëshmor Veli Ballazhi nga Hani i Elezit, bastisjet dhe reprezaljet serbe u zbrazën edhe në shtëpinë e Sabedin Hasallarit ku vëllau i tij Zylbehari, si kryetar i degës së LDK-së, torturohet rëndë nga forcat policore serbe. Sabedini duke e parë vëllaun e tij nën tortura, reagon dhe ndeshet me policinë serbe në oborrin e shtëpisë. Në këtë rast, policia e arreston Sabedinin dhe krahas torturave, në procedurë të shpejtë e dënojnë me 10 muaj burg. Këtu fillon edhe odiseada tjetër e Sabedinit. Nga Ferizaj dërgohet në burgun e Prishtinës dhe nga Prishtina në atë të Lypjanit, ku torturat ndaj të burgosurve ishin të padurueshme. Më 30 prill 1999 e transferojnë në burgun e Dubravës ku prej të gjitha anëve po i grumbullonin të burgosurit, pasiqë skenari për masakër kolektive tanimë ishte bërë. Në Dubravë takohet edhe me shokët e tjerë nga Hani Elezit që i sollën në këtë burg.

Sabedini është përjetues i masakrës serbe ndaj të burgosurve shqiptarë nga 19 – 24 maj 1999, ku mbetën të vrarë 117 të burgosur e mbi 200 të plagosur e në mesin e të vrarëve ishte edhe Suad Brava nga Hani i Elezit, ku Sabedini, krahas shokëve të tjerë shquhet për ndihmën e dhënë. Me 24 maj transferohet në burgun e Lypjanit prej kah më 10 qershor 1999, transferohet në burgun e Nishit, si peng lufte, ku krahas torturave, të

burgosurit përballeshin edhe me uri të padurueshme. Edhe pse Sabedinit i kishte skaduar afati i dënimit, ai mbahej ende në burg. Prej burgut të Nishit lirohet më 16 gusht 1999. Është rrënqethës udhëtimi i tij nga Nishi deri në Preshevë, sepse në atë kohë ende nuk ishte arritur marrëveshja me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar për përcjelljen e të burgosurve nga burgjet serbe për në Kosovë, kështuqë ishte evidente mundësia e likuidimit të Sabedinit gjatë rrugës. Megjithate, ai arrinë në Preshevë ku preshevarët arrijnë ta fusin në Kosovë. Është ndër personat e parë që nga burgjet serbe u lirua në vitin 1999. Sabedin Hasallari ka qenë edhe asambleist i Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit. Jeton në Lagje të Re të Hanit të Elezit dhe është anëtar i Shoqatës së të Burgosurve Politik të Kosovës.

Shefket Beqa është i lindur më 4.4.1979 në fshatin Laç të Hanit të Elezit. Ciklin e ulët të fillores e kreu në vendlindje , ndërsa të lartin në fshatin Kotlinë, kurse të mesmen në Han të Elezit.

Fundshkurti dhe marsi i vitit 1999 ishte arenë luftimesh mes forcave të UÇK-së dhe forcave pushtuese

serbe. Në fshatrat e Grykës së Kaçanikut gjëmonin armët. Betejat e para ishin zhvilluar që me 26 shkurt 1999 në Puset e Nikës, ndërsa me 2 mars ishte ofenziva e madhe armike duke vazhduar edhe ditëve në vijim në Ivajë, Gajre e Kotlinë. Në luftë ishin pothuajse të gjitha fshatrat e Grykës. Në këto rrethana më 9 mars 1999, arrestohet në fshatin Laç edhe Shefket Beqa dhe akuzohet nga gjykata pushtuese si pjesëtar i UÇK-së. Hetimet ndaj Shefket Beqës zhvillohen në burgun e Gjilanit ku edhe torturohet rëndë. Në Gjilan qëndron deri më 30 prill 1999, ku bashkë me shokët e tjerë, si Ylber Topallin, Xhevat Hazirin, Skender Ferizin, Fatmir Kurtajn, Besim Zymberin, Qamil Abazin, Gafurr Lumën e shumë të tjerë, transferohet për në burgun e Dubravës, ku edhe e përjeton masakrën serbe ndaj të burgosurve shqiptar. Me 24 maj e transferojnë në Lipjan, prej kah më 10 qershor 1999, si rob lufte transferohet në Mitrovicë të Sremit. Nga burgu i Mitrovicës së Sremit transferohen në burgun e Nishit dhe më 29 qershor të vitit 2000 lirohet. Një karakteristikë tjetër e Shefket Beqës në burgjet serbe ishte edhe kënga, me të cilën ndikonte në ngritjen e moralit tek të burgosurit, të cilët krahas torturave fizike e psiqike, luftonin edhe me urinë e tmerrshme. Shefket Beqa sot, krahas punëve të tjera, tanimë është një rapsod i njohur i kësaj ane dhe jo vetëm, ku me

zërin e tij melodik i këndon luftës çlirimtare, heronjëve të kombit e në mesin e tyre edhe shokëve të burgut që ranë dëshmorë. Është i martuar dhe jeton në fshatin Laç të Hanit të Elezit.

Qamil Abazi

(1965-2017)

Qamil Abazi është i lindur më 2.2.1965 në fshatin Pojatishtë të Ferizajt. Ka të kryer shkollën fillore. Nga Pojatishta shpërngulet në Han të Elezit. Nga forcat policore serbe arrestohet më 8 mars 1999 dhe e dërgojnë në burgun e Gjilanit. Akuzohet si pjesëtarë i UÇK-së. Nga burgu i Gjilanit transferohet në ate të Dubravës ku përjeton masakrën serbe nga 19 maji e deri më 24 maj 1999. Gjatë torturave, edhe më shumë i dëmtohet shëndeti, duke ia dëmtuar edhe veshkët. Pas masakrës në burgun e Dubravës transferohet në atë të Lipjanit dhe me 10 qershor 1999 merret si peng lufte bashkë me të burgosurit e tjerë në Mitrovicë të Sremit. Nga Mitrovica e Sremit transferohet në atë të Nishit ku edhe lirohet më datën 29 qershor 2000. Qamil Abazi vdes në vitin 2017. Fëmijët e tij tani jetojnë në komunën e Ferizajt.

Selim Loku

(1953-2014)

Selim Loku është i lindur më 19.1.1953 në fshatin Kotlinë të Kaçanikut. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa dy vite të shkollës së mesme në Ferizaj. Më vonë shpërngulet në Lagjen e Ujit të Thartë në Han të Elezit. Punon në fabrikën e Sallonitit në Han të Elezit. Selim Loku rrjedh nga një familje me tradita atdhetare e cila luftës për liri i ka dhënë luftëtarë dhe dëshmorë. Arrestohet nga policia serbe më 1 prill 1999 bashkë me djalin e tij Samiun. Në fakt, Selim Loku vie nga Puset e Nikës në shtëpi për ta tërhequr djalin e tij Samiun. Sapo futet në shtëpi, hetohet nga policia, rrethohet dhe e arrestojnë bashkë me djalin e tij i cili lirohet më vonë. Nga një deklaratë e tij prej 18 faqeve, lexohet tmerri që ka përjetuar Selim Loku gjatë hetuesisë. Torturohet rëndë në stacionin policor të Hanit të Elezit bashkë me djalin e tij Samiun. Torturohet për tri ditë me radhë nga komandanti i ushtrisë i quajtur Millani, pastaj nga policët : Braca, Oliveri, Tita, Joca, Çiça, Mile Radiqi, Millan Betegalla, dhe disa të tjerë që ishin të maskuar. Nga torturat ia thyejnë brinjët, krahun, ashtin e

hundës, shtypje në gjoks, therje me thikë... dhe në këtë gjendje shëndetësore dhe me një thes të zi në kokë e dërgojnë në Ferizaj, në një shtëpi me dërrasa ku i vazhdojnë torturat. Gjatë torturave ia heqin edhe çizmet dhe për gjashtë muaj me radhë ka qenë i zbathur. Nga Ferizaj, bashkë me djalin e tij Samiun e dërgojnë në burgun e Prishtinës. Në burgun e Prishtinës e ndajnë edhe nga djali. Me 2 maj 1999 e transferojnë në burgun e Lypjanit, ku edhe torturohet nga policia e në mesin e tyre edhe Moma i Kaçanikut të Vjetër. Në burgun e Lypjanit ka qëndruar në dhomë edhe me Albin Kurtin ku torturohen rëndë, ku krahas torturave ka mbizotëruar edhe uria. Nga burgu në burg, Selim Lokut nuk ia kanë hequr uniformën e UÇK-së dhe në çdo burg ka qenë shumë i torturuar. Më 10 qershor 1999, nga burgu i Lypjanit merret si peng lufte dhe dërgohet në burgun e Pozharevcit në Serbi. Në këto rrethana i humbin edhe dokumentet e akuzës, ku ngarkohej si pjesëtar i UÇK-së, armëmbajtje dhe strehim në bunker. Nga burgu lirohet më 13 qershor të vitit 2000, bashkë me 19 të burgosur të tjerë. Selim Loku ishte babai i tetë fëmijëve. Vdes nga sëmundja e kancerit në dhjetorin e vitit 2014.

Samet Ballazhi është i lindur më 8.9.1977 në Lagje të Re të Hanit të Elezit. Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit, ndërsa të mesmen në Kaçanik.

Rrjedh nga një familje me tradita atdhetare. Që në vitin 1987, vëllau i tij Nexhati bie në burg për Republikën e Kosovës, bashkë me disa shokë të tjerë dhe dënohet me 2 vite burg. Në odën e madhe të kësaj familje fisnike, kanë qëndruar burra me vlerë kombëtare dhe fryma e lirisë gjithmonë ka qenë prezente. Në këtë frymë lirie u rrit edhe Samet Ballazhi i cili radhëve të UÇK-së i bashkangjitet që nga tetori i vitit 1998, ku bashkë me Veli Ballazhin dhe Mehmedali Ballazhin, kalojnë në Tiranë e nga Tirana në qendrën stërvitore Vlanë të cilën e udhëhiqte Mehmet Ballazhi zv.komandant i Brigadës 164 në Han të Elezit. Në këtë qendër stërvitore, kishte edhe ushtarë të tjerë nga Hani i Elezit. Me 13 dhjetor, nën udhëheqjen e Mujë Krasniqit bashkë me 148 ushtarë të tjerë, nëpër një mot shumë të vështirë me borë e acar, nga Cahani futen në Pashtrik për të vazhduar më tej brenda Kosovës në zona lufte. Por në orët e hershme të mëngjesit të 14 dhjetorit 1998, kolona me ushtarë të UÇK-së, bien në

pritën e ushtrisë serbe në vendin e quajtur Lkenet e Hasit. Tanimë kolona ishte e rrethuar nga të gjitha anët dhe zhvillohen luftime të rrepta, ku edhe bien në altarin e lirisë 41 dëshmorë e në mesin e tyre Veli Ballazhi, ndërsa Samet Ballazhi plagoset rëndë në kokë. Në këtë gjendje, zihet robë lufte edhe Samet Ballazhi bashkë me gjashtë pjesëtarë të tjerë të UÇK-së. Të arrestuarit i dërgojnë në burgun e Prizrenit ku i torturojnë rëndë. Pas dy dite, nga burgu i Prizrenit me helikopter ushtarak i dërgojnë në burgun e Nishit duke i keqtrajtuar në vazhdimësi.

Po atyre ditëve, UÇK-ja arriti që në fronte lufte t`i zë robër nëntë ushtarë serb. Kjo ishte një mundësi e mirë që UÇK-ja të bëhet pjesë, përkatësisht faktor i padiskutueshëm lufte përballë Serbisë, andaj kërkoi edhe shkëmbimin e të arrestuarve. Me ndihmën dhe me ndërmjetësimin e OSBE-së, Serbia detyrohet të bëj shkëmbimin e robërve të luftës dhe në këtë mes, krahas të tjerëve, lirohet edhe Samet Ballazhi. Sameti lirohet më 23 janar 1999, pas 40 dite qëndrim në burg dhe dërgohen në shtabin e UÇK-së në Likoc.

Pas lufte, Samet Ballazhi shërben në Policinë e Kosovës ku është edhe sot. Është i martuar dhe babai i dy fëmijëve. Është invalid i UÇK-së. Jeton në Lagje të Re të Hanit të Elezit.

Azem Suma është i lindur 4.7.1972 në Han të Elezit.

Shkollën fillore e kreu në Han të Elezit ndërsa të mesmen në Kaçanik.

Radhëve të UÇK-së u bashkangjitet që në tetorin e vitit 1998 dhe nëpërmjet Maqedonisë kalojnë në Tiranë dhe nga Tirana në qendrën stërvitore në Vlanë. Më 13 dhjetor 1998, bashkë me shumë bashkëluftëtarë nisen për tu futur në Kosovë nëpërmjet Pashtrikut. Kolona udhëhiqej nga komandant Mujë Krasniqi. Para mëngjesit të 14 dhjetorit bien në pritën e organizuar serbe në Lkenet e Hasit ku zhvillohen luftime të përgjakshme ndërmjet luftëtarëve të UÇK-së dhe forcave ushtarake serbe. Në mesin e këtyre luftëtarëve ishte edhe Azem Suma. Përveq Azem Sumës, nga Hani i Elezit ishin edhe Samet Ballazhi, Veli Ballazhi, Avni Shiti, Vehbi Mici, Mehmedali Ballazhi. Krahas luftës, luftëtarët e lirisë ballafaqoheshin edhe me borën dhe acarin e madhë. Në këtë lufte plagoset edhe Azem Suma dhe i plagosur zihet robë lufte nga forcat serbe. Të arrestuarit i dërgojnë në burgun e Prizrenit ku edhe torturohen rëndë. Pas dy dite, nga burgu i Prizrenit i dërgojnë në burgun e Nishit. Në këtë burg ushtarak, Azem Suma

qëndron 40 ditë dhe ndërkohë bëhet edhe ndërrimi i njohur me ushtarët e zënë serbë dhe lirohet më 23 janar 1999. Një rol të madh ndërmjetësues luajti OSBE –ja dhe nën përcjelljen e saj futen në Kosovë, përkatësisht në Shtabin e UÇK-së në Likoc.
Azem Suma është i martuar, babai i dy fëmijëve dhe është invalid i UÇK-së. Aktualisht është kryetar i degës së Organizatës së Invalidëve të UÇK-së në Han të Elezit.



Akik Qajani është i lindur më 28.12.1956 në fshatin Krivenik të Hanit të Elezit. Më vonë, familja e tij shpërngulet në Han të Elezit. Pas kryerjes së shkollës fillore dhe atë të mesme, e kryen edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike ku punon si mësues në fshatin e tij të lindjes e më vonë edhe Drejtor i shkollës fillore në Han të Elezit.
Zgjedhja e tij si drejtor shkolle, ishte një sfidë jo e vogël për, pasiqë viti 1990 shënon edhe ngjarje të mëdha si 2 korrikun, shpalljen e pavarësisë së Kosovës në Prishtinë, 7 shtatorin 1990, shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës në Kaçanik, Referendumin e viti 1991, të cilat i bënte alternativa kosovare e asaj kohe, por në anën tjetër, pushtuesi serb ndërmori masa

represive ku krahas largimit të punëtorëve nga puna, ndaloi edhe shkollën shqipe. Në këto rrethana të rënda politike, gjersa para shkollës po mbahej një protestë në mbrojtje të shkollës shqipe, drejtori i shkollës fillore Akik Qajani, tha se shkollat të mos punojnë me planprogramet serbe siç kërkonte pushtuesi, por vetëm me ato që kërkohen nga Këshilli Pedagogjik i Kosovës, Lidhja e Arsimtarëve Shqiptar (LASH) dhe Sindikata shqiptare. Ky ishte edhe shkaku i burgosjes së Akik Qajanit. Në fakt, policia serbe këtë shkollë e kishte „vizituar" edhe me 7 tetor 1991, ku nga drejtori i shkollës kishin kërkuar t`i dorëzoj 10 pushkë ajrore të kabinetit të Mbrojtjes, ndërsa para disa muajve kishin marrë edhe revolen zyrtare të shkollës dhe të rojës fizike. Akuza e ngarkonte *se „Me datën 1.10.1991 dhe 2.10.1991, në oborrin e shkollës fillore ka mbajtur fjalime para nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve, duke kërkuar që të vazhdoj mësimi me planprograme shqipe, milicia serbe mos të bën represion ndaj fëmijëve dhe shqiptarëve, duke i shprehur këto edhe me transparente"*. Ky ishte shkasi për burgosjen e Akik Qajanit, ndërsa shkaku ishte ndërprerja e çdo gjëje që ishte shqiptare dhe për këtë veprim ai dënohet me 60 ditë burg të cilin edhe e vuan në burgun e Prishtinës nga data 14.10.1991 e deri më 13.12.1991. Dhe jo vetëm kaq, zullumi serb ndaj Akik Qajani vazhdon edhe më tej. Me pretekst të kërkimit të

armëve, torturohet rëndë dhe me ditë e javë të tëra s`ka mundur as të ushqehet me duartë e veta. Është ndër të arrestuarit që ka pësuar shumë në torturë. Pas gjithë këtyre burgosjeve e malltretimeve, Akik Qajani në vitin 1995 detyrohet të lëshon Kosovën dhe të emigroj në Zvicërr ku qëndron edhe sot.